

Raport i Vlerësimit të Jashtëm

Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani”

Raport Final

25 qershor 2015

1. Hyrje	3
1.1. Konteksti	3
1.2. Ekspertët.....	3
1.3. Shkurtesat e përdorura.....	3
1.4. Procedura dhe mbledhja e provave	4
1.4.1 Raporti i Vetë Vlerësimit (RVV)	4
1.4.2. Vizita në Institucion	4
1.4.3. Dokumentet shtesë	5
2. Vlerësimi institucional.....	5
2.1 Deklarata e misionit dhe strategjia	6
2.2 Organizimi dhe menaxhimi	6
2.3 Personeli, caktimi i personelit dhe zhvillimi i tij.....	6
2.4 Financat.....	6
2.5 Plani i zhvillimit	6
2.6 Menaxhimi i Cilësisë	7
2.7 Ndërkombëtarizimi	7
3. Programet e Studimit	8
3.2 Programi Bachelor në “Fizioterapi”	12
3.5 Bachelor in ‘Marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe Studimet e BE’	31
3.6 Bachelor në Administratë Publike dhe Bachelor në Shkenca Politike.....	44
3.6.1 Bachelor në “Administratë Publike”	50
3.6.2 Bachelor në “Shkencat Politike”	57
3.7 Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Gjermane”	60
3.8.1 Vërejtje të përgjithshme	60
3.8.2 Programi Akademik dhe Menaxhimi i Studentëve	60
3.8.3 Personeli.....	63
3.8.5 Puna Kërkimore	64
3.8.6 Bashkëpunimi Ndërkombëtar	65

1. Hyrje

1.1. Konteksti

Ky dokument paraqet raportin përfundimtar të vlerësimit 2015 për Universitetin e Gjakovës “Fehmi Agani” (UGJ), në Kosovë. Ky raport është si rezultat i punës ekipore i një ekipi ndërkombëtar ekspertësh të përzgjedhur nga Agjencia e Akreditimit të Kosovës (AAK) për të vlerësuar programet e studimit të UGJ. Ky raport është i bazuar në raportin e vetë vlerësimit (RVV 1) të UGJ, në raportin e vetë vlerësimit të shtuar (RVV 2) për programin e studimeve në gjuhën dhe letërsinë gjermane, në vizitën e grupit të ekspertëve (ekipit të ekspertëve – EE) në Gjakovë më 12 maj 2015 dhe informatat shtesë të UGJ, të pyetura nga EE.

1.2. Ekspertët

EE përbëhej nga ekspertët në vijim:

- Prof. Dr. Reiner Doluschitz/ Universiteti i Hohenhajmit - Shtutgart (DE)
- Prof. Dr. Volker Frederking/ Universiteti i Erlangenit-Nyremberg (DE)
- Prof. Dr. Frederic Mertens de Wilmars/ Universiteti i Valencias (ES)
- Prof. Dr. Reinhard Meyers/ Universiteti i Munster (DE)
- Prof. Dr. Wolfgang Patsch/ Universiteti i Mjekësisë Paracelsus (AT)
- Prof. Dr. Milan Pol/ Universiteti Masaryk (CZ)

1.3. Shkurtesat e përdorura

Shkurtesat në vijim janë përdorur në këtë dokument:

EE	Ekipi i Ekspertëve
AL	Arsimi i Lartë
AAK	Agjencia e Akreditimit të Kosovës
VI	Vizita në Institucion
SC	Sigurimi i Cilësisë
RVV	Raporti i Vetë Vlerësimit
UGJ	Universiteti i Gjakovës
UP	Universiteti i Prishtinës

1.4. Procedura dhe mbledhja e provave

1.4.1 Raporti i Vetë Vlerësimit (RVV)

UGJ ka dorëzuar një RVV të detajuar (RVV 1) si dokument kryesor për akreditim institucional dhe për akreditim të programeve të studimeve. Raporti përshkruan në 409 faqe në mënyrë të veçantë programet e studimeve në vijim:

1. Edukimin e Hershëm të Fëmijëve (0-3 vjet)
2. Fizioterapia
3. Bioteknologjia
4. Pylltaria
5. Marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe Studimet e BE
6. Administratë Publike
7. Shkenca Politike

RVV e programit të studimeve “Gjuhë dhe Letërsi Gjermane” (RVV 2) me 91 faqe u shtua si dokument i veçantë.

RVV 1 dhe RVV 2 i mundësuan EE që të krijojë një pamje të qartë të situatës së tanishme në lidhje me programet e studimeve në UGJ dhe paraqisnin një bazë të mirë informative për të përgatitur VI.

1.4.2. Vizita në Institucion

Më 11 maj, gjashtë ekspertët u takuan në mbrëmje për një darkë pune paraprake së bashku me dy anëtarë të AAK:

- Znj Furtuna Mehmeti, Eksperte për Vlerësim dhe Akreditim (AAK)
- Z Fisnik Gashi, Zyrtar për Vlerësim dhe Monitorim (AAK)

Ata diskutuan për përshtypjet e tyre të para dhe për raportet RVV (RVV 1+2) të UGJ dhe programin për VI në ditën në vijim. Prof. Dr. Milan Pol u pajtua që të udhëheqë komitetin, Prof. Dr. Volker Frederking mori përsipër që të shkruajë pjesët e përgjithshme të raportit dhe t'i integrojë gjithë kapitujt e kolegëve në një dokument. Përgjegjësitë për programet e studimeve u ndan si në vijim:

1. Edukimin e Hershëm të Fëmijëve (0-3 vjet) (*Pol*)
2. Fizioterapia (*Patsch*)
3. Bioteknologjia (*Doluschitz*)
4. Pylltaria (*Doluschitz*)
5. Marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe Studimet e BE (*Mertens*)
6. Administratë Publike (*Meyers*)
7. Shkenca Politike (*Frederking*)

Më 12 maj EE kaloi një ditë në UGJ.

EE u shoqërua nga tre anëtarë të AAK:

- Znj Furtuna Mehmeti, Eksperte për Vlerësim dhe Akreditim (AAK)
- Z Fisnik Gashi, Zyrtar për Vlerësim dhe Monitorim (AAK)
- Z Shkelzen Gerxhaliu, Zyrtar për Vlerësim dhe Monitorim (AAK)

VI u zhvillua sipas planit. VI e planifikuar filloi në mëngjesin e 12 majit me takimin me menaxhmentin e institucionit duke filluar nga 0900-0930. Pastaj EE u nda në grupe të vogla për takime me personat përgjegjës të disa programeve të studimeve nga 0930-1130. Vizita në mjedise vijoi më pastaj (1130_1230). Pastaj ishte dreka e punës e EE me Koordinatorët e AAK (1230-1400) dhe një kohë e shkurtër që u shpenzua për konsultime të brendshme (1400-1415), vizita përfundoi me një takim përfundimtar me menaxhmentin e institucionit (1415_1430).

EE do të donte t'i shprehte mirënjohjen menaxhmentit të UGJ "Fehmi Agani" dhe përfaqësuesve të disa programeve të studimeve për organizimin shumë të mirë të vizitës më 12 maj 2015.

Veç kësaj, EE do të donte të falenderonte ngrohtësisht AAK dhe në veçanti Znj Furtuna Mehmeti, Z Fisnik Gashi, Z Shkelzen Gerxhaliu dhe Prof. Dr. Ferdije Zhushi-Etemi për mbështetjen e tyre shembullore dhe bashkëpunimin para, gjatë dhe pas vizitës.

1.4.3. Dokumentet shtesë

Pas VI u kërkuan disa dokumente shtesë. Ato u dërguan menjëherë nga ana e menaxhmentit të institucionit.

2. Vlerësimi institucional

Qeveria e Kosovës ka themeluar Universitetin e Gjakovës "Fehmi Agani" me dekretin numër 02/118 në mars 2013 dhe me ratifikimin e dekretit nga ana e Parlamentit të Kosovës në maj 2013. UGJ filloi të veprojë më 1 tetor 2013 me një departament të Edukimit me programet në Edukimin Parashkollor, në atë Fillor, me një Departament të Mjekësisë me programet në Infermeri dhe Mami, një departament të Filozofisë me programe në Gjuhën dhe Letërsinë Shqipe dhe atë Angleze. Këto programe janë akredituar nga AAK në prill 2013. Në prill 2014 UGJ iu nënshtrua procesit të akreditimit. Një shqyrtim i plotë institucional u ndërmor më pastaj dhe një numër programesh studimi u vlerësuan nga një EE ndërkombëtar. EE në maj 2015 pajtohet me analizat dhe rekomandimet e EE të prillit 2014.

2.1 Deklarata e misionit dhe strategjia

Duke u mbështetur në RVV dhe në raportin e EE të 2014 dhe më pastaj duke u bazuar edhe në takimin me pjesëtarët e menaxhmentit të UGJ, EE ka përshtypjen që Deklarata e Misionit të UGJ është e kënaqshme dhe ofron një vizion të qartë për standardet e kërkuara për institucionit.

2.2 Organizimi dhe menaxhimi

Themelimi i UGJ duhet të konsiderohet si një përpjekje kuptimplote për zhvillimin e arsimit dhe shkencës në Kosovë. Duke u bazuar në RVV 1 dhe 2 si dhe pas takimit me përfaqësuesit e universitetit, EE është impresionuar nga organizimi profesional dhe menaxhimi i UGJ.

2.3 Personeli, caktimi i personelit dhe zhvillimi i tij

Gjendja sa i përket personelit sigurisht që është e veçantë gjatë krijimit të një strukture të re në UGJ. Një pjesë e personelit vjen nga UP. Kjo është e bazuar në kontratën në mes dy universiteteve që të mundësohet ofrimi i programeve pa pengesa. Pjesa tjetër e UGJ ka qenë dhe do të pranohet në bazë të një konkursi publik. EE pajtohet me synimin e menaxhmentit dhe me rekomandimet e EE 2014 që UGJ në total do të duhej të kishte rreth 95 profesorë në vitet në vijim, sepse ky numër do të ishte në përputhje me standardet evropiane që të sigurojë një raport numerik të mirë në mes të studentëve dhe profesorëve. Në përfundim, rekomandohet që UGJ të vijojë me përpilimin e politikave konkrete që ndihmojnë integrimin e personelit akademik, personelit mbështetës mësimor dhe personelit jo akademik. EE poashtu pajtohet me rekomandimet e vlerësimit institucional 2014 që UGJ do të duhej t'i kushtonte vëmendje orientimit hulumtues të personelit të punësuar në të ardhmen dhe do të duhej të sqaronte udhëzimet institucionale në lidhje me zhvillimin e standardeve të cilësisë në punë kërkimore.

2.4 Financat

UGJ financiarisht mbështetet nga shteti. Komuna e Gjakovës poashtu mëton që të përfshihet përmes mbështetjes së infrastrukturës së universitetit, veçanërisht sa i përket kampusit të ri të synuar të Universitetit. Plani financiar për vitet në vijim është bindës me “pak kripë”.

2.5 Plani i zhvillimit

EE i 2014 tashmë ka theksuar, që UGJ “Fehmi Agani” ka një kuptim të qëndrueshëm të zhvillimit institucional. Plani zhvillimor i UGJ është përpiluar duke u bazuar në parimet e zhvillimit të Universitetit, duke marrë parasysh që

disa programe kanë filluar në tetor 2013 në mënyrë që të plotësojnë nevojat e përbashkëta zhvillimore të programeve duke përfshirë ato të reja. Por, thënë në përgjithësi UGJ është në rrugë të mbarë. Ka plane konkrete për zgjerim. UGJ ka dedikuar një hapësirë prej 132,095 m² nga Asambleja Komunale për ndërtimin e kampusit të ri universitar.

2.6 Menaxhimi i Cilësisë

Vlerësimi institucional i 2014 ka theksuar që UGJ ka krijuar Zyrën për Zhvillim Akademik dhe Menaxhim të Cilësisë me synimin për të siguruar cilësinë e shkëlqyer, barazinë, transparencën dhe efikasitetin. Universiteti poashtu i është dedikuar performancës së cilësisë së lartë në secilin departament dhe program dhe e konsideron përmirësimin e cilësisë si një përgjegjësi individuale dhe kolektive. Universiteti është duke krijuar një kulturë për cilësi duke i kushtuar vëmendje të veçantë sigurimit të cilësisë dhe menaxhmentit. Synimi kryesor i menaxhimit të cilësisë është zhvillimi efektiv dhe monitorimi i politikave dhe procedurave. Përderisa ka udhëzime të qarta në lidhje me sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, EE ka përshtypjen që përpjekjet për të mbështetur dhe për të përmirësuar cilësinë në punë kërkimore duhet të intensifikohen, në mënyrë që të dëshmojnë që UGJ është një qendër e punës kërkimore të cilësisë së lartë.

2.7 Ndërkombëtarizimi

UGJ ka prezantuar një strategji për ndërkombëtarizim. Ka bashkëpunime të ngushta me Universitetin e Shkencave Aplikative të Mynsterit (MUAS). Me Institutin e Evropë Jugore për Avancimet në Shkencat Shëndetësore dhe të Infermierisë (SEE) që përbëhet nga “QEAP – Heimerer”, një qendër edukative për arsimin profesional. Universiteti ka arritur të bashkëpunojë edhe me Universitetin e Mariborit, Slloveni dhe me Universitetin e Shkencave Mjekësore Hall/Tyrol (UMIT), me Universitetin Shtetëror të Tiranës, Universiteti i Mjekësisë i Tiranës, me Universitetin e Shkodrës “Luigj Garaçiqi”, me Universitetin e Vlorës “Ismail Qemali” me Universitetin e Tetovës, me Universitetin e Pejës “Haxhi Zeka” dhe me Universitetin e Prizrenit “Ukshin Hoti”. UGJ poashtu është i përfshirë në programin e studimeve Tempus “Struktura e reformave interdisciplinare dhe profesionet inovative për Arsimin e Lartë”. Megjithatë, në përgjithësi, e ardhmja duhet të tregojë se çfarë ndikimi do të kenë këto reforma të bashkëpunimit ndërkombëtar tek studentët, për personelin dhe për punën kërkimore të UGJ.

3. Programet e Studimit

Pjesët e ndryshme të programeve të studimit janë shkruar nga anëtarë të ndryshëm të EE. Si rrjedhojë, ato mund të ndryshojnë në strukturë dhe në formë.

3.1 Bachelor në “Edukimin e Hershëm të Fëmijëve”

Prof. Dr. Milan Pol

Hyrje

Kam pasë mundësinë që të vizitoj UGJ “Fehmi Agani”, Fakultetin e Edukimit gjatë vitit të kaluar si pjesë e procesit të akreditimit të dy programeve bachelor: Edukim Parashkollor; dhe Edukim Fillor. Programi që tani është në vlerësim duket që përmbush boshllëkun ekzistues duke qenë se synon të përgatisë specialistë për punën e tyre me fëmijët e vegjësl (0-3). Përderisa dy programet e para të cekura (dhe të akredituara në vitin e kaluar) ishin disi si vazhdim i asaj që është përmbushur paraprakisht nën ombrellën e UP, programi i Edukimit të Hershëm të Fëmijëve mendohet që të paraqesë një program krejtësisht të ri.

Programi Akademik dhe Menaxhimi i Studentëve

Programi duket se është në përputhje me vizionin dhe poashtu edhe me misionin e UGJ, Fakultetin e Edukimit siç është cekur edhe në RVV. Ambicja është që të përgatiten specialistë (edukatorë, mësimdhënës) për të trija nivelet fillestare të arsimit: Fëmijëri e hershme, parashkollor dhe arsim fillor. Ka kuptim që të ofrohet një gamë e tillë programesh në një institucion, kjo nëse ka nevojë të shprehur nga shoqëria (rajoni) dhe institucioni është i gatshëm që të zbatojë programe të tilla.

Programi Bachelor, Edukimi i Hershëm i Fëmijëve është planifikuar si një program 4 vjeçar (240 kredi ECTS – kreditë janë llogaritur në mënyrë të pranueshme), që duhet të ndjeket vetëm nga studentë të rregullt. Kurrikula e programit është ndërtuar në mënyrë logjike, ka një gradim të brendshëm, ka elementet kryesore tipike të programit të një profili të tillë dhe në përgjithësi më duket përmbajtje relevante.

Synimet e programit janë cekur dhe rezultatet e mësimt janë përpiluar. Unë do të propozoja që t'i kushtohet pak më shumë vëmendje këtyre formulimeve dhe poashtu edhe kompatibilitetit të këtyre dy grupeve të formulimeve (synimeve-rezultateve të pritura të mësimt), më shumë specifikime precizë kërkohen në disa raste.

Ngjashmë me dy programet tjera (ato që i kam shqyrtuar vitin e kaluar), edhe në këtë rast më duket se numri i përgjithshëm i lëndëve është shumë i madh. Do të rekomandoja përpilimin e një pgorami që do të ishte rreth “gurëve kryesorë” me disa mundësi opcionale që do të ishin të ndërlidhura me këta “gurë kryesorë”. Sistemi i tanishëm ka rrezik të fragmentohet dhe të ketë një izolim të disa lëndëve të caktuara, si rrjedhojë është më vështirë që të trajtohen marrëdhëniet në mes diciplinave të veçanta dhe çështjeve ndër-diciplinare. Megjithëse RVV pohon që janë tri grupe diciplinash të lëndëve (“të përgjithshme, akademike dhe metodike-didaktike”), Unë propozoj që të fuqizohen dhe ndoshta të shndërrohen në më eksplicite aspektet integruese të kurrikulës së programeve.

Kriteret e pranimit janë të përshkruara në mënyrë të qartë dhe përmbajnë kërkesa të pranueshme. Provimi përfundimtar është i përqendruar në mbrojtjen e tezës së diplomës, nuk ka një provim final të integruar (pyes vetën nëse ky integrim i dijeve, siç zakonisht ofrohet nga programe të tilla do të duhej vlerësuar më shumë (e kam vërejtur që kjo është një çështje që shpërfaqet shpesh në programet edukative në Kosovë)). Sistemi i vlerësimit të arritjes së studentëve përmes programit të studimeve (në lëndë të veçanta) duket që është menduar mirë.

Ngjashëm me dy programet që kam shqyrtuar vitin e kaluar, orari i programit indikon që ka një numër relativisht të madh të orëve të mësimit në javë, përgjatë gjithë kohës së studimeve në tetë semestra. Mund të vërej arsyet kryesore në lidhje me këtë, megjithatë unë jam ithtar i asaj që të shqyrtohen mundësitë për të balancuar disi në kurrikulë mësimin e drejtpërdrejtë kundrejt mësimit të pavarur. Unë jam i vetëdijshëm që kjo është e ndërlidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me atë se sa janë në dispozicion resurset për studime. Megjithatë, besoj që studentët e arsimit të lartë meritojnë një shans për të zhvilluar shkathtësitë e punës akademike të pavarur.

Në kurrikulë ka një proporcion të mirë në mes të diciplinave teorike dhe “praktike”. Praktika profesionale duket se është e organizuar mirë dhe në masë adekuate (22 javë gjatë 4 vjet studimesh, në masë të madhe nën mbikqyrjen e mentorëve). Metodatat mësimdhënëse siç janë përshkruar në RVV janë të pranueshme në kontekstin e tanishëm.

Literatura e studimeve ndonjëherë është në anglisht, pyes vetën se sa reale është kjo, kjo edhe duke marrë parasysh gjendjen e keqe në të cilën është biblioteka dhe fakti që nuk shfrytëzohen databazat relevante.

Numri i studentëve që është planifikuar të regjistrohen (50 në vitin akademik 2015/2016) duket se është i pranueshëm.

Personeli

Mbulimi me personel duket se është një nga çështjet kryesore në zhvillimin e tanishëm të arsimit të lartë në Kosovë. Mund të vlerësohen përpjekjet e UGJ, Fakultetit të Edukimit që të joshin personelin e ri përmes konkurseve publike.

Deri më tani, megjithatë, rezultatet nuk duket të jenë të kënaqshme. Lista zyrtare e personelit që është konfirmuar nga ana e AAK shpërfaq në mënyrë të qartë që në programin bachelor Edukim i Hershëm i Fëmijëve ka vetëm katër (4) anëtarë të personelit (nga lista me 36 persona) që janë të punësuar ekskluzivisht në UGJ, Fakultetin e Edukimit. Në mesin e tyre është rektori (profesor) dhe tre pjesëtarë të tjerë të personelit (që të tre me diploma të masterit). Pjesa tjetër e personelit të regjistruar duket se është angazhuar diku tjetër ose nuk është e ndërlidhur me asnjë institucion të arsimit të lartë. Megjithëse gjatë intervistimit të personave të ngarkuar me programin kam marrë informacion disi të ndryshëm, në përgjithësi duket se çështja e personelit është mjaft kritike këtu. Nuk synoj të nënvlerësoj kontributin potencial të personelit të jashtëm që vjen nga UP dhe/ose institucionet tjera një herë në javë në bllok ligjerata, siç duket të jetë praktika tani, megjithatë kjo nuk paraqet një bazë të shëndoshë për një program tjetër të ri.

Puna kërkimore dhe Bashkëpunimi ndërkombëtar

Ngjashëm me atë çfarë kam shkruar në shqyrtimin e vitit të kaluar në lidhje me dy programet bachelor në këtë institucion, mund të shkruaj përsëri: puna kërkimore paraqet një aspekt të dobët të gjithë nismës, e njëjta mund të thuhet edhe për bashkëpunimin ndërkombëtar.

Sa i përket punës kërkimore, një vëmendje i është kushtuar kësaj çështjeje në kurrikulë (lëndët siç janë hulumtimet, bazat e punës hulumtuese në fëmijërinë e hershme, e ndërlidhur me javët e punës praktike), më duket se kjo është ngritur në mënyrë adekuate në program. Megjithëse është cekur përfshirja e personelit në punë kërkuese, sa i përket listës zyrtare të personelit (shih seksionin ku flitet për personelin) megjithatë këto dëshmojnë të dhëna të varfra.

Sa i përket ndërkombëtarizimit, përveç marrëveshjeve të bashkëpunimit me Universitetin Shtetëror të Tiranës, ka vetëm plane për t'u kyçur në rrjete ndërkombëtare dhe në bashkëpunime tjera. Tani për tani, ka një nivel shumë të ulët të ndërkombëtarizimit në UGJ, në Fakultetin e Edukimit. Programi Edukimi në Fëmijërinë e Hershme pretendon që ka ngjashmëri me disa programe ndërkombëtare, por deri më tani nuk vërehet një lidhje eksplicite dhe e gjatë me botën ndërkombëtare.

Financat dhe Infrastruktura

Edhe më tej financat janë të centralizuara në nivel të universitetit. Megjithatë informatat bazike në lidhje me financimin e programit ishin në dispozicion. Plani për periudhën 2015-2017 parasheh rritje financiare të shpenzimeve në paga, të mira dhe shërbime, në incentiva dhe transfere dhe në asete jofinanciare. Shpjegimi sa i përket aspektit edukativ-punës kërkimore-dhe ndërkombëtarizimit nuk është shpjeguar në detajet e duhura.

Sa i përket infrastrukturës, infrastruktura bazë (ndërtesat, klasat e mësimit) janë në dispozicion dhe janë duke u shfrytëzuar. Në vitin e kaluar është vënë në përdorim edhe ndërtesa e re (rindërtuar). Sipas menaxhmentit të UGJ, financat për kampusin e ri tashmë janë miratuar dhe kjo do të krijojë kushtet për jetën universitare në një nivel më të lartë në periudhën prej 3 deri 5 vjetët e ardhshme. Brenga ime ende mbetet sa i përket resurseve të bibliotekës. Unë konsideroj që ajo është në gjendje shumë të keqe. Edhe databazat nuk janë duke u shfrytëzuar (edhe ato të parapaguara nga ministria) dhe nuk ekziston një sistem informativ i standardizuar, studentët dhe personeli komunikojnë përmes emailave personale dhe disa rrjeteve sociale. Kjo nuk është e mjaftueshme më për një institucion të arsimit të lartë më ambicie solide sa i përket të qenit në hap më kohën me mundësitë për të studiuar në arsim të lartë, si institucion udhëheqës në rajonit e Gjakovës dhe përtej.

Menaxhimi i Cilësisë

Zyra për Zhvillim Akademik dhe Menaxhim të Cilësisë është themeluar në Universitetin e Gjakovës, kjo çështje është cekur edhe në RVV. Kjo duket të paraqesë një hap përpara në krahasim me vitin e kaluar, duke qenë se atëherë ishte vetëm në plan të bëhej. Duhet të adaptohen disa masa sa i përket sigurimit të cilësisë, e që veçanërisht kanë të bëjnë me procesin mësime/mësues/mësues (vlerësimet e studentëve, vlerësimet e personelit). Nuk është e qartë se cila është procedura e trajtimit të të dhënave të mbledhura në këtë mënyrë. Këto masa të vlerësimit nuk janë fokusuar në mënyrë eksplicite në punën kërkimore dhe në ndërkombëtarizim.

Rekomandimi kryesor ndaj Bordit të AAK

Nuk kam dyshim që UGJ, Fakulteti i Edukimit ka ndërmarrë hapa pozitivë, vetë programi duket se është përpiluar mirë, mjediset janë duke u përmirësuar (ndërtesa e rindërtuar) dhe procesi i menaxhimit të cilësisë është duke u ngritur në mënyrë graduale. Disa fusha të funksionimit kanë nevojë për më shumë vëmendje dhe për përmirësim (në masë të madhe sa i përket resurseve të studimit, punës kërkimore dhe ndërkombëtarizimit).

Unë rekomandoj që të ndërlidhet akreditimi me çështjen e personelit. Kjo çështje duket të jetë më kritikja sa i përket programit të ri, duke marrë parasysh listën zyrtare të personelit. Nëse kjo qëndron kështu si është, atëherë rekomandoj që tani të mos akreditohet programi bachelor në Edukimin në Fëmijërinë e Hershme.

21 qershor 2015

Prof. Dr. Milan Pol (Universiteti Masaryk, Republika Çeke)

3.2 Programi Bachelor në “Fizioterapi”

Prof. Dr. Wolfgang Patsch

Informata të përgjithshme

UGJ, Fakulteti i Mjekësisë, më parë ka aplikuar për programin bachelor në Fizioterapi, por në 2014 EE rekomandoi që ky program të mos akreditohej, duke qenë se aplikimi nuk plotësonte kushtet për akreditim. Pikat kryesore të kritikës ishin kushtet e këqia të mjediseve mësimdhënëse, mungesa e kabinetit të shkathtësive dhe një mungesë e plotë e personelit mësimor kompetent. UGJ ka riaplikuar për të njëjtin program në 2014.

1. Programi Akademik dhe Menaxhimi i Studentëve

Programi në Fizioterapi është në përputhje me misionin e institucionit dhe me parimet e operimit. Në RVV, aplikuesit deklarojnë që programi i tyre është 80% i krahasueshëm me programet e tri universiteteve tjera evropiane (UP, Fakulteti i Mjekësisë, Fizioterapia, Kosovë; Universiteti i Lubjanës, Fakulteti i Mjekësisë, Fizioterapia, Slloveni; Universiteti i Zagrebit, Fakulteti i Mjekësisë, Fizioterapia, Kroaci). Megjithatë, nuk janë bërë përpjekje që të shpërfaqen aspektet e ngjashme të programit sa i përket kurrikulës, personelit mësimdhënës dhe pajisjeve në dispozicion. Megjithatë, kurrikula në masë të madhe mbulon kërkesat e arsimit të lartë në fizioterapi dhe tani është paraqitur në formën e duhur, dmth ligjeratat, detyrat/seminaret, trajnimi klinik dhe studiet individuale, që të gjitha janë shpërfaqur.

Programi i studimeve përbëhet nga 6 semestre përgjatë 3 vjetësh të studimeve të rregullta (180 kredi ECTS). Një kredi (1) ECTS është e barasvlefshme me tridhjetë (30) orë studimesh. Të gjitha lëndët janë të vlerësuara sipas vlerave ECTS. Caktimi i ECTS është adekuat dhe i arsyetuar.

Programi do të pranojë 50 studentë në vit. Testi i pranimit, kualifikimi dhe procedurat e pranimit janë adekuate. Pas përfundimit të suksesshëm të programit, diploma akademike “Bachelor në Fizioterapi” do të jepet për studentët.

Një çështje e madhe kritike ka të bëjë me përgatitjen e dobët të RVV. Në përgjithësi aplikimi është vështirë i lexueshëm. Përveç mungesave në lidhje me përdorimin e anglishtes, aplikimi ndonjëherë përsërit të njëjtë paragrafë dhe i prezanton ata në arsyetime të dobëta. Referencat sa i përket literaturës janë të pasakta. Në mënyrë të përsëritur, aplikimi i referohet trajnimit në infermieri, në vend se në fizioterapi. Kjo është zhgënjyese, për shkak se të njëjta gabime janë vërejtur edhe në vlerësimin paraprak dhe janë konsideruar si copy/paste nga programi i infermierisë. Përgjigjja e UGJ ndaj raportit vlerësuar paraprak pohon

që përkthyesit kanë bërë këto gabime “të vogla”. Megjithatë, UGJ ka një Departament të anglishtes dhe ngrihet pyetja, pse kolegëve nga ky departament nuk iu është kërkuar që të ndihmojnë në këtë aspekt. Veç kësaj, gabimet nuk ishin të vogla. Për shembull, citimi korrekt i referencave paraqet një praktikë të mirë shkencore, që është pjesë thelbësore për arsim të lartë. Përveç kësaj, në disa planprograme të Ndihmës së Parë mungojnë pika që kanë të bëjnë me ringjalljen kardio pulmonare. Kjo çështja e fundit është sqaruar dhe disa mungesa janë adresuar në mënyrë të duhur gjatë prezantimit verbal të programit gjatë VI.

Një pikë e dytë e madhe kritike ka të bëjë me mungesën e përshkrimit të detajuar të praktikës klinike sa i përket procedurave specifike të trajtimit dhe llojeve të pacientëve. Veç kësaj, nuk është e qartë se si administrohet praktika klinike, duke qenë se ajo do të zhvillohet në disa institucione të ofrimit të shërbimeve shëndetësore në lokacione të tjera dhe në qendrën e mjekësisë terciare në Prishtinë. Një dokument i dorëzuar pas VI ka adresuar këtë kritikë në mënyrë të pjeshme. Një grafik që do të paraqiste organizatat që përcjellin këto aktivitete, do të ishte më i dobishëm: vendi dhe koha, ku dhe kur marrin pjesë studentët, numri i studentëve që janë në punë praktike në secilin lokacion në të njëjtën kohë, procedurat që duhet të mësohen në lokacione të ndryshme dhe mbikqyrësit lokalë që janë të ngarkuar me vlerësimin e studentëve në lokacione të ndryshme.

2. Personeli

RVV cek anëtarët e personelit të Fakultetit të Mjekësisë që tashmë janë të angazhuar në programet tjera të studimeve. Modulet e mësimdhënies cekin një numër doktorësh të arsimuar në nivel akademik. Një numër i madh i këtyre praktikentëve medicinalë është i punësuar me orar të plotë nga institucionet tjera. Poashtu ka një mungesë të fizioterapeutëve të arsimuar në nivel akademik. Një dokument i dorëzuar pas VI cek përsëri listën e gjithë Fakultetit të Mjekësisë dhe përfshintë një MSc në Fizioterapi. Megjithatë, personeli që do të marrë pjesë në program të fizioterapisë nuk është i specifikuar në dokumentin e dorëzuar pas VI. Në përgjigje ndaj raportit paraprak të vlerësimit, UGJ pohon që “NE NUK DO TË THYEJMË LIGJIN dhe të punësojmë personelin e rregullt në program të Fizioterapisë pa fituar akreditimin më parë”. EE kurrë nuk ka pasë si synim që të kërkojë zhvillimin e veprimeve që thyejnë ligjin, por është e arsyeshme që të kërkohet informacioni që ofron siguri në lidhje me mundësitë e personelit të ardhshëm në mënyrë që të plotësohen kërkesat për mësimdhënie në fizioterapi në nivel të lartë arsimor.

3. Puna kërkimore dhe Bashkëpunimi Ndërkombëtar

UGJ, Fakulteti i Mjekësisë, cek disa programe kërkimore. Këto përfshijnë temat në vijim: “Konceptet Bazike në lidhje me personin, shëndetin, sëmundjen dhe rolin e fizioterapeutit në kujdesin bazik”; “Sistemi funksional iurvejimit të sëmundjeve ortopedike-traumatologjike në Kosovë”; “Menaxhimi i stresit në

punë". Këto programe janë të bazuara në pyetësorë të shumtë. Edhe pse këto programe kërkimore mund të jenë me vlerë, ato në masë të madhe adresojnë çështjet e shëndetit publik dhe ato socioekonomike dhe nuk janë specifike për shkencën e fizioterapisë. Mund të pritej që të kishte më shumë tema adekuate që ndërlidhen me mjekësinë e bazuar në fakte dhe më shumë drejtpërdrejtë me fizioterapinë.

Një aspekt mjaft pozitiv i përpjekjeve hulumtuese është organizimi i një takimi shkencor që është planifikuar për shtator 2018, dmth pas diplomit të gjeneratës së parë të fizioterapeutëve. Studentët më të mirë të gjeneratës do të kenë mundësi që të prezantojnë punën e tyre në këtë konferencë.

RVV poashtu cek që studentët do të kenë mundësinë të angazhohen në programet shkencore të universiteteve tjera evropiane që janë në bashkëpunim me UGJ. Megjithatë, nuk janë cekur universitetet mikëpritëse për studime të tilla. Veç kësaj, përderisa UGJ cek bashkëpunimet me universitetet tjera, nuk është e qartë nëse këto bashkëpunime kanë të bëjnë edhe me diciplinën e fizioterapisë.

4. Financat dhe Infrastruktura

Ndërtesa është e madhe, është renovuar dhe ka një numër të mjaftueshëm sallash mësimi dhe të punës praktike. Pajisjet në dispozicion sa i përket fizioterapisë janë disi të mangëta. Një zhvillim mjaft pozitiv paraqet rritja e fondit në lidhje me literaturën moderne dhe me librat mësimorë. Kjo është mundësuar nga donacionet e komunitetit vendor. Për këtë arsye është kredibil argumenti që pajisjet e nevojshme për fizioterapi do të përmirësohen, poashtu. Në përgjigje ndaj VI, u ofrua një dokument shtesë që përmbante një shpjegim të buxhetit. Buxheti i gjithmbarshëm për Fakultetin e Mjekësisë ishte 342.618,00 për vitin 2015. Më tej dokumenti pohon "pas procesit të akreditimit, me rishikimin e buxhetit, UGJ do të ndajë financimin për dy programet akademike të reja (tabela më poshtë)". Kjo tabelë më poshtë paraqet buxhetin vjetor për Fakultetin e Mjekësisë që do të jetë 121.840,00. Kjo ndarje nga Fakulteti i Mjekësisë nuk është shpjeguar në asnjë detaj dhe një zvogëlim i buxhetit nuk është cekur gjatë vlerësimit të programit në fizioterapi, kjo gjatë VI. Sipas tabelës, pagat do të preken më së shumti nga zvogëlimi. Në dritën e reduktimeve të tilla të mëdha, nuk është e qartë se si do të mund të fillojë një program i ri dhe nëse mund të mbahet numri i personelit adekuat për të.

5. Menaxhimi i Cilësisë

UGJ ka një program të sigurimit të cilësisë që është organizuar nga koordinatori që është përgjegjës për koordinimin e kontrollit të cilësisë në të gjitha programet. Janë vënë në funksion disa masa shtesë të sigurimit të cilësisë në programet tjera akademike. Një masë mjaft e rëndësishme dhe bindëse sa i përket kontrollit të cilësisë do të mund të ishte përcjellja e aktiviteteve të ardhshme dhe e punësimit të të diplomuarve. Ngjashëm me këtë, testimet në fizioterapi që zhvillohen në

universitetet tjera mund të shfrytëzohen për të përcaktuar suksesin e studentëve të UGJ.

Rekomandim

Pas një shqyrtimi të kujdesshëm të aplikimit që përfshiu VI dhe dokumentet që u dorëzuan pas VI nga ana e UGJ, EE rekomandon një akreditim me kusht të Programit në Fizioterapi për një numër deri 50 studentë. EE dëshiron të theksojë nocionin me kusht. Në përgjigjen e tyre ndaj raportit paraprak të vlerësimit, UGJ nuk shpjegoi zvogëlimin në buxhet për Fakultetin e Mjekësisë. Si rrjedhojë, nga UGJ kërkohet një deklaratë pa ekuivoke që të shpjegojë çfarëdo ndikimi që do të ketë në programin e Fizioterapisë ky reduktim i buxhetit. Në një deklaratë të tillë, duhet të sigurohet që ka një munër adekuat dhe cilësi të personelit mësues. Nëse këto siguri nuk mund të garantohen, EE rekomandon që Programi në Fizioterapi të mos akreditohet tani për tani.

Prof. Dr. Wolfgang Patsch, Universiteti Mjekësor Paracelsus Salzburg, Austri

3.3 Programi Bachelor në “Bioteknologji”

Prof. Dr. Reiner Doluschitz

Vërejtje hyrëse

Baza e këtij raporti janë

- Dokumenti i aplikimit i dorëzuar nga institucioni aplikues
- RVV i institucionit aplikues së bashku me shtojcën e dokumenteve shtesë
- Gjetjet nga VI më 11 dhe 12 maj 2015
- Material shtesë që është kërkuar nga institucioni aplikues

1. Vërejtje të përgjithshme

Programi i studimeve që i është nënshtruar vlerësimit është themeluar në vitin 2014 si rrjedhojë e kërkesës së vërejtur për të diplomuar nga ky program në tregun e punës. Nje herë në vit, një numër prej më së shumti 50 studentësh mund të regjistrohen në këtë program, kjo nga grupi prej 200 aplikantësh. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara është përgjegjës për këtë program BSc.

2. Programi Akademik dhe Menaxhimi i Studentëve

- **A korrespondon programi akademik me deklaratën e misionit dhe me parimet e operimit të institucionit?**

Programi i studimeve është në përputhje me misionin e institucionit. Megjithatë, deklarata e misionit e Universitetit duhet të përmirësohet më tej siç është rekomanduar në Raportin Përfundimtar për akreditimin institucional dhe të programeve të vitit 2014. Ka një zotim të fortë nga ana e Bordit dhe Senatit të Universitetit si dhe nga Ministria e Arsimit. Programi ka “dritën e gjelbër” nga të gjitha institucionet e përfshira. Ai i përgjigjet kërkesave të tregut të punës në Kosovë, është i pritur mirë nga studentët, mbështet synimin e institucionit për të kualifikuar dhe për të përgatitur studentët për nivelet e larta arsimore, veçanërisht për programet Master dhe PhD në të ardhmen. Megjithatë, duke qenë se të diplomuarit e parë pritet të vijnë vetëm në 2017, ende nuk ka dëshmi empirike në lidhje me këtë. Programi i studimeve Bioteknologji (BSc.) poashtu është në përputhje me strategjinë zhvillimore kombëtare të Kosovës.

- **A është në përputhje me diplomën akademike cilësia e programit, shtrirja dhe synimet akademike?**

Po. Shtrirja e moduleve në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe është adekuate me diplomën akademike. Ajo poashtu është në përputhje me programet e ofruara nga institucionet partnere edhe në nivelin

ndërkombëtar siç janë ai i Universitetit të Lubjanës, Zagrebit dhe Tiranës. Studentët duhet të kualifikohen për pozitat në kompanitë private dhe institucionet publike në përputhje me zinxhret furnizuese në agro ushqime dhe ato të ngjashme (psh në atë mjekësor, farmaceutik). Fatkeqësisht, si rrjedhojë e faktit që kemi të bëjmë me fazën e hershme të zbatimit të programit, nuk mund të vlerësohen ende vërejtjet e studentëve sa i përket “elementeve praktike”, siç janë internshipet në kompanitë private, në vizitat fushore, ftesat për praktikantë në sektorin e bioteknologjisë, aktivitetet praktike etj. Megjithatë, në RVV është cekur që është planifikuar dërgimi i studentëve për praktikë eksperimentale në universitetet partnere jashtë vendit, veçanërisht në Lubjanë dhe në Tiranë. Përsëri, për të garantuar standarde të larta dhe të njëtrajtshme në cilësi dhe efikasitet, kërkohet të ketë një koncept didaktik gjithëpërfshirës dhe një sistem efikas i sigurimit të cilësisë dhe këto duhet të zbatohen sa më shpejt që të jetë e mundur. Kjo vlen edhe për mangësitë pontenciale në fushën e trajnimeve të shkathtësive të buta që duhet të ofrohen jashtë programeve bazë të studimeve. Aftësitë gjuhësore kërkohen shumë si dhe prezantimi dhe aftësitë negociuese. Këto përmbajtje duhet të përfshihen në programin e tanishëm të studimeve dhe duhet të vlerësohen pas aplikimit të parë duke përfshirë edhe komentet e vërejtjet e studentëve.

- **A është programi i bazuar në konceptin didaktik gjithëpërfshirës që i është komunikuar në mënyrë adekuate dhe është adoptuar nga personeli mësimor?**

(Ende) Nuk është i dukshëm në mënyrë të qartë një koncept didaktik gjithëpërfshirës. Programi i studimeve në vlerësim është zbatuar vetëm për një kohë të shkurtër deri më tani. Përvojat respektive, duke përfshirë komentet dhe mendimet e studentëve, tani për tani nuk janë në dispozicion. Një vlerësim në vijim pas një, maksimum dy vjetësh do të duhej të ofronte informata më gjithëpërfshirëse, duke përfshirë përvojat e fituara. Kjo do të duhej të përfshinte edhe pyetjen në lidhje me zbatimin në nivel të Universitetit të Platformës së Përbashkët të Mësimit (psh ILIAS). Kjo do të mund të kontribuonte në përmirësimin e informacionit dhe rrjedhës së komunikimit dhe do të mund të paraqiste një instrument gjithëpërfshirës sa i përket efikasitetit dhe sigurimit të cilësisë. Duke qenë se personeli mësimor ofrohet deri në masën 90% nga institucionet partnere në Kosovë dhe jashtë saj, që shfrytëzojnë koncepte të ndryshme didaktike, atëherë për këtë arsye unifikimi do të ishte mjaft i nevojshëm për zhvillimin e një koncepti të përbashkët didaktik në Universitetin e Gjakovës.

- **A është në përputhje me standardet ndërkombëtare diploma akademike?**

Në përgjithësi, po. Programet studimore janë në një masë të madhe në përputhje me programet e ngjashme në shtetet e Evropës Perëndimore. Është edhe

parakusht që zbatimi i programit të jetë në masën >80% identik në përmbajtje kjo krahasuar me programet respektive jashtë vendit.

- **A ofron struktura e programit mundësi të mjaftueshme për punë të pavarur studimore, për reflektim dhe analizë? (p.sh. cili është proporcioni i punës së pavarur studimore krahasuar me mësimdhënien online/në distancë kundrejt mësimin në klasa?)**

Koncepti i kalkulimit të caktimit të ECTS për modulet përfshin mjaft hapësirë për ushtrime, detyra shtëpie dhe për studim të pavarur. Megjithatë, në këtë fazë fillestare të zbatimit të programit, ende nuk mund të ofrohet dëshmi empirike në lidhje me zbatimin e tij. Një vlerësim në vijim pas një viti, maksimum dy vitesh do të mund të ofronte informata më gjithëpërfshirëse, duke përfshirë edhe përvojat e arritura, veçanërisht nga ana e studentëve. Në përgjithësi mund të rekomandohet që ofrimi i materialit mësimor (të shkruar, prezantimet në power point, artikujt shkencor, etj) duhet të përmirësohet dhe të përfshijë edhe komponentë ndërkombëtarë. Ky do të mund të paraqiste parakushtin kyç për studime të pavarura e intenzive. Siç është cekur më sipër, zbatimi i një Platforme të Unifikuar të Mësimin do të mund të ofronte kontribut të çmueshëm në këtë aspekt dhe do të mund të zgjeronte gamën e opsioneve për studime të pavarura, veçanërisht sa i përket proporcionit në mes të mësimdhënies online/në distancë. Veç kësaj, një platformë e tillë do të mund të ofronte qasje nga distanca për studentët në materialet dhe informacionin që ka të bëjë me programin e studimeve dhe në këtë mënyrë ka potencial për zvogëlimin e barrave administrative dhe organizative.

- **A është adekuat dhe i arsyetuar caktimi i kredive ECTS?**

Po.

- **A është e përballueshme nga studentët ngarkesa e kërkuar nga programi akademik?**

Në përgjithësi, dhe sipas materialeve të vëna në dispozicion, po. Megjithatë, është tepër herët që të komentohet në mënyrë gjithëpërfshirëse në lidhje me këtë pyetje. Janë të nevojshme diskutimet respektive me studentët që të indikohen shpërputhjet dhe/ose ngarkesa e tepërt. Siç ndodh rëndom në programet e studimeve, ka ngarkesa maksimale sezonale gjatë kohës së provimeve. Në anën tjetër kjo paraqet një ushtrim të mirë për studentët që të organizojnë kohën në mënyrë të duhur dhe të punojnë në “projekte” të ndryshme në mënyrë paralele, siç do t’iu kërkohet edhe nga vendet e tyre të punës në të ardhmen. Veçanërisht për sqarimin e kësaj çështjeje, komentet e studentëve të bazuara në përvojat e mjaftueshme do të mund të kërkoheshin. Këto përvoja ende nuk janë në dispozicion si rrjedhojë e kohës së shkurtër të zbatimit të programit. Kjo pyetje duhet të marrë përgjigje në procedurën e vlerësimit në vijim posa të ketë në dispozicion përvojë të mjaftueshme në këtë program.

- **A janë të mjaftueshme për arritjen e synimeve të programit dhe të rezultateve (kompetenca dhe kualifikimet, njohuritë dhe shkathhtësitë) metoda e mësimdhënies dhe përmbajtja e njësive mësimore?**

Një parakusht për zbatim të suksesshëm të detyrave të tilla është zgjerimi i kapaciteteve sa i përket personelit mësimor të kualifikuar. Rekomandohet fuqimisht që të punësohet personel i rregullt në UGJ (jo mësimdhënës me orar jo të plotë që vijnë nga institucionet tjera!). Këta pjesëtarë të personelit do të duhej të shërbenin si persona kyçë sa i përket konceptit didaktik të unifikuar dhe të garantonin standarde të larta të cilësisë. Duket se nuk ka dyshime sa i përket kualifikimeve të mësimdhënësve të veçantë që vijnë nga jashtë. Megjithatë, është vështirë të krijohet një frymë ekipore në gjendjen e tanishme. Potenciali për përmirësim sa i përket metodave të mësimdhënies dhe përmbajtjes shkojnë së bashku me zbatimin e një Platforme të fuqishme të Mësimi dhe inkorporimi gjinjë e më i madh i “Elementeve Praktike” në program, siç është cekur më lart.

- **A është kuptimplotë dhe transparente mbivendosja e përmbajtjes akademike në mes pjesëve të ndryshme të kurrikulës?**

Disa mangësi sa i përket transparencës ranë në sy gjatë diskutimeve në VI, veçanërisht në fushën e modulev. Përmirësimet në lidhje me sistemin e mentorëve specifikë do të mund të përmirësonin situatën dhe t'i përgatisnin studentët që të ngrisin një profil adekuat sa i përket synimeve të tyre për punësim në të ardhmen. Poashtu, në këtë kuptim, përvojat e bëra nga vetë studentët do të ishin të një vlere të madhe. Përsëri, kjo do të kërkonte një përcjellje të procedurës së vlerësimit dhe atë sa më parë.

- **Sa janë në përputhje me standardet ndërkombëtare kriteret dhe procedurat e pranimit?**

Duke qenë se numri i aplikantëve për program qartësisht tejkalon kapacitetet e vendeve të mësimi në dispozicion, atëherë një procedurë e pranimit është vënë në funksion. Ko është bërë përmes notave të vlerësimit prej testeve në shkollë, si dhe nga niveli i njohjes së gjuhës angleze dhe përmes testimit në shkencat natyrore dhe matematike, si dhe letrës motivuese, kjo e fundit indikon pritshmëritë personale të studentëve. Kjo është plotësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare.

- **A është adekuat raporti numerik në mes personelit akademik/artistik dhe studentëve?**

Në përgjithësi po. Raporti numerik në mes personelit akademik dhe studentëve është adekuat dhe mundeson të gjitha format e qasjes didaktike. Megjithatë, siç është cekur më parë, ka një mungesë të personelit akademik që është punësuar nga UGJ me orar të plotë. Ky raport numerik duhet zgjeruar sa më parë dhe si rrjedhojë të zvogëlohet numri i personelit vizitues dhe nga institucionet fqinje. Veç kësaj, “komponentet praktike” do të duhej zgjeruar në programet e studimit.

Kjo kërkon më shumë kapacitete kadrovike. Ngarkesa në rritje që pritet për personelin do të duhej të mbështeste disbalancin në mes ngarkesës kundrejt ngritjes së cilësisë dhe potencialit inovativ.

3. Personeli

- **A ka institucioni proporcion adekuat të personelit të rregullt dhe proporcion të duhur në mes personelit të rregullt dhe atij të jashtëm?**

Jo aspak. Siç u cek më lart, tani gati 200 aplikime mbulojnë rreth 50 vende studimi në nivelin BSc.

Tani për tani rreth 90% e profesorëve nuk kanë punësim të rregullt në UGJ, por merren në bazë të punës me honorar nga institucionet partnere. Duket që nuk ka personel tjetër mësimor përveç profesorëve vizitues. Mbi këtë bazë është vështirë që të krijohet dhe të zhvillohet më tej një program studimesh në mënyrë të qëndrueshme, që do të plotësonte standardet e larta dhe do të kontribuonte në konceptin didaktik gjithëpërfshirës. Ata mezi janë në gjendje që të udhëheqin programin ekzistues dhe nuk ka në dispozicion kapacitete që të mbulohen përmbajtjet e reja në fushën e Bioteknologjisë. Rekomandohet fuqimisht që të bëhet një zgjerim sa i përket personelit mësimor të kualifikuar dhe të rregullt në UGJ. Kjo do të mundësonte dhe lejonte më shumë aktivitete shkëmbyese ndërkombëtare dhe plotësimin me diploma PhD jashtë vendit.

- **A demonstroi personeli akademik aftësi në nivel të lartë akademik dhe didaktik dhe a janë kualifikimet e tyre adekuate me pozitat që ata i mbajnë brenda institucionit në përputhje me kriteret bazë?**

Sipas kriterëve ekzistues (të kufizuara) për punë kërkimore dhe pjesëmarrje në rrjetet ndërkombëtare, në shoqatat shkencore dhe në konferencat ndërkombëtare, atëherë kualifikimet e personelit duket se janë të mjaftueshme. Megjithatë, ky personel duke qenë se nuk është i lidhur me institucionin që është nën vlerësim në bazë të kontratave me orar të plotë, atëherë kjo vështirë që mundëson krijimin e projekteve hulumtuese që so të ofronte përmbajtje të fjalës së fundit për programet mësimore. Këto projekte hulumtuese në anën tjetër janë një nga parakushtet kryesore për kualifikimin e personelit dhe për nisjen e karrierave akademike (PhD) dhe për përcjelljen e niveleve akademike. Tani për tani nuk janë të dukshme projektet hulumtuese në fushën e Bioteknologjisë që do të ofronin një bazë për karriera të tilla. Në perspektivë, mbetet shpresa që do të kualifikohet personel shtesë në vitet në vijim dhe do të jenë në gjendje që të plotësojnë pozitat mësimdhënëse në përputhje me standardet e kërkuara të cilësisë. Do të duhej që sa më parë të vlerësohen përmirësimet në këtë aspekt përmes një procedure vlerësimi në vijim.

4. Hulumtimet dhe Bashkëpunimi ndërkombëtar

- **A është i përfshirë në aktiviteti hulumtuese personeli mësimor brenda ose jashtë institucionit dhe a janë të ndërlidhura me procesin mësimor/përmbajtjen e lëndëve mësimore këto aktivitete hulumtuese?**

Duke qenë se deri tani nuk ka gati fare personel të rregullt akademik që është punësuar nga UGJ, nuk ka as përfshirje në hulumtime e që janë të ndërlidhura me UGJ në fushën e Bioteknologjisë. Sigurisht që ka aktivitete hulumtuese në universitetet amë të bëra nga personeli me orar jo të plotë. Por këto nuk janë pjesë e këtij vlerësimi. Siç u cek më lart, përfshirja e personelit në aktivitetet hulumtuese mund të vërehet vetëm në masë të kufizuar si rrjedhojë e kapaciteteve të kufizuara dhe kufizimeve në burime financiare. Për këtë arsye, mundësitë që gjetjet nga puna hulumtuese të kenë ndikim në përmbajtjen e lëndëve mësimore janë të kufizuara në masë të madhe. Kjo vlen posaçërisht sa i përket rezultateve të projekteve interdisiplinare/ndërkombëtare dhe të konferencave ndërkombëtare dhe publikimeve e literaturës respektive në fushë. Ka një potencial të madh që do të mund të shfrytëzohej përmes caktimit të fondeve financiare shtesë dhe burimeve tjera të nevojshme në diciplinën e Bioteknologjisë, një kërkese e veçantë do të mund të ishte nevoja për personel të rregullt akademik.

- **A janë adekuate shtrirja dhe cilësia e bashkëpunimit ndërkombëtar në hulumtime dhe mësimdhënie?**

Sa i përket pohimeve të cekura më sipër ka një potencial të ndjeshëm që nuk është shfrytëzuar dhe që do të mund të shfrytëzohej përmes caktimit të resurseve të nevojshme. Prioritet i parë dhe parakusht do të ishte punësimi i personelit mësimor në bazë permanente që në anën tjetër do të ishte në gjendje që të krijonte dhe të mbështeste kontaktet ndërkombëtare si dhe aktivitetet hulumtuese.

- **A janë të përfshirë studentët në projekte hulumtuese dhe të bashkëpunimit?**

Duke qenë se tani për tani nuk ka studentë në semestra të avancuar dhe duke qenë se nuk ka gati aspak aktivitete hulumtuese në fushën e bioteknologjisë, nuk ka as përfshirje të studentëve në hulumtime. Si rrjedhojë, ka poashtu një mungesë sa i përket projekteve interdisciplinare dhe ndërkombëtare.

5. Financat dhe Infrastruktura/Mjediset dhe Pajisjet

- **A ka institucioni një plan buxhetor adekuat?**

Në përgjithësi, po, por fondet që janë në dispozicion nuk janë definuar në mënyrë të qartë organeve akademike të Universitetit dhe janë larg të qenit të mjaftueshme për një mësimdhënie dhe hulumtime progresive që është e orientuar drejt së ardhmes. Përveç aplikimit për fonde publike do të duhej eksploruar mundësinë dhe krijimin e lidhjeve të rrjeteve përmes ish studentëve

dhe nga partneritetet private, duke përfshirë fitimin e fondeve, këto do të duhej bërë në të ardhmen.

- **A ka institucioni ndërtesa adekuate dhe infrastrukturë të specializuar për kërkesat e programit?**

Kapacitetet sa i përket ndërtesave dhe cilësisë duket se janë të mjaftueshme. Klasat janë të pajisura me pajisje të prezantimit dhe audio. Në përgjithësi ka në dispozicion laboratorë kompjuterikë, por me qasje të kufizuar dhe në sasi të kufizuar. Zbatimi i rekomanduar i platformës së unifikuar të mësimit dhe përmirësimet sa i përket komunikimit të studentëve do të kishin nevojë për infrastrukturë shtesë TIK. Mungojnë tekste specifike dhe qasja në shkrime akademike do të duhej garantuar kundrejt asnjë Faqese. Ofrimi i hapësirave me tavolina për studentë në faza të fundit të studimeve do të vlerësohej shumë dhe do të kontribuonte në shkallën e suksesit. Do të duhej ofruar mundësi dhe kapacitete të mjaftueshme të transportit. Planifikohet të ketë infrastrukturë të re sa i përket ndërtesave që do t'i vihen në dispozicion Fakultetit të Shkencave Aplikative dhe ato do të jenë në dispozicion të programeve të studimit që janë në vlerësim.

6. Menaxhimi i Cilësisë

- **A vlerësohen programet e institucionit në bazë të rregullt brenda kontekstit të proceseve të brendshme të vlerësimit?**

Po. Vlerësimi ndodh në baza të rregullta përmes pyetësorëve për studentë për vlerësimin e lëndëve mësimore dhe mësimdhënësve. Veç kësaj, bëhen edhe vlerësime dhe procedura të akreditimit që ndodhin në bazë të rregullt nga jashtë dhe në mënyrë të pavarur.

Përmbledhje e përgjithshme e vlerësimit

Në përmbledhje të vërejtjeve të cekura më lart, mund të jepen rekomandimet në vijim për ngritje të mëtejme të programit:

- Më e rëndësishmja është që të punësohet në bazë të rregullt personel mësimor, që do të zëvendësonte një pjesë të personelit me orar jo të plotë dhe që do të krijonte një bazë afatgjatë dhe të qëndrueshme për përmirësimin e strukturave gjithëpërfshirëse mësimdhënëse dhe do të mundësonte krijimin e aktiviteteve hulumtuese.
- Vazhdimi dhe konsolidimi i strukturës së tanishme të moduleve dhe veç kësaj do të duhej të eksplorohej dhe të inkorporohej fushat e reja dhe temat e reja në programet e studimit.
- Caktimi i fondeve financiare shtesë dhe burimeve të kërkuara për fillimin dhe mbështetjen e aktiviteteve hulumtuese, veçanërisht ka nevojë për aktivitet hulumtues në nivel interdisciplinar dhe ndërkombëtar. Është afër mendsh që

kërkesa nga tregu i punës për të diplomuar nga ky program studimesh do të jetë mjaft e lartë brenda një afati të mesëm dhe afatgjatë. Personeli mësimor dhe të diplomuarit e nivelit master do të duhej të josheshin përmes mundësive për të përfunduar PhD jashtë vendit, kjo do të duhej të ishte një parakusht urgjent për të zëvendësuar personelin e tanishëm akademik dhe të plotësoheshin pozitat akademike me kandidatë cilësorë. Do të duhej krijuar një model publik privat (të Bioteknologjisë) për të mbështetur hulumtimet aplikative.

Rekomandimet

- Të mos bëhet akreditimi në formën e tanishme.
- Kjo në masë të madhe është si rrjedhojë e situatës mjaft të jositurë sa i përket personelit akademik të rregullt që është i ndërlidhur me këto programe.
- Duhet të dorëzohet përsëri një aplikim pasi të jenë bërë ndryshimet sa i përket pikave kritike dhe zbatimit të rekomandimeve të dhëna në këtë raport vlerësimi.

Prof. Dr. sc. agr. Reiner Doluschitz
Universiteti i Hohenheimit, Shtuttgart, Gjermani
Instituti i Menaxhimit të Fermave

3.4 Bachelor në “Pylltari”

Prof. Dr. Reiner Doluschitz

1. Vërejtje të përgjithshme

Programi i studimeve në vlerësim është krijuar në vitin 2014 si rrjedhojë e:

- kërkesës së vërejtur për të diplomuar në këtë program në tregun e punës,
- Arsim të lartë joekzistues ose të kufizuar në fushën e Pylltarisë në Kosovë dhe në disa shtete fqinjë, poashtu

Për këtë arsye, arsimi i lartë në fushën e Pylltarisë do të mund të ishte disi një “Ofertë Unike e Shitjes” për UGJ që është krijuar së voni. Në anën tjetër, tani për tani ka mungesë të personelit akademik në këtë fushë.

Një herë në vit më së shumti 50 studentë mund të regjistrohen në program, nga rreth 200 aplikantë. Fakulteti i Shkencave aplikative është përgjegjës për programin BSc.

Duke qenë se pylltaria paraqet një program studimesh të ri, shumë nga aspektet që i janë caktuar programit të Bioteknologjisë vlejné edhe për këtë program. Në këtë kuptim, argumentet e vlerësimit janë në masë të madhe të përmbledhur në formë të pohimeve në vijim.

2. Academic Program and Student Management

- **A korrespondon programi akademik me deklaratën e misionit dhe me parimet e operimit të institucionit?**

Programi i studimeve është në përputhje me misionin e institucionit dhe është i mbështetur gjerësisht nga UGJ dhe nga njësitë institucionale. Ka një kërkesë të madhe për inxhinierë të pylltarisë, veçanërisht në sektorin publik (80% e pyjeve janë në pronësi të shtetit), pjesërisht nga institucionet private, psh Paqet Kombëtare.

Siç u cek më sipër në Bioteknologji, deklarata e misionit e Universitetit duhet të përmirësohet më tej siç është rekomanduar në Raportin Final të Akreditimit Institucional dhe të Programeve të vitit 2014. Duke qenë se të diplomuarit e parë mund të priten në vitin 2017, ende nuk ka të dhëna empirike. Programi i studimeve në Pylltari (BSc.) është poashtu në përputhje me strategjinë zhvillimore kombëtare të Kosovës.

- **A është në përputhje me diplomën akademike cilësia e programit, shtrirja dhe synimet akademike?**

Po. Në përgjithësi gama e moduleve është në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe është adekuate me diplomën akademike. Ajo është poashtu në përputhje me programet e ofruara nga institucionet partnere edhe në nivel

ndërkombëtar siç janë Universiteti i Lubjanës, Zagrebit dhe Tiranës. Të diplomuarit do të duhej të kualifikoheshin për vende punë në masë të madhe për sektorin publik. "Elementet praktikë" siç janë internshipet janë planifikuar në semestret e fundit të studimeve. Komentet e bëra në lidhje me programin në Bioteknologji mund të zbatohen edhe këtu në mënyrë respektive.

- **A është programi i bazuar në konceptin didaktik gjithëpërfshirës që i është komunikuar në mënyrë adekuate dhe është adoptuar nga personeli mësimor?**

(Ende) Nuk është plotësisht i dukshëm një koncept didaktik gjithëpërfshirës. Komentet e bëra në lidhje me programin në Bioteknologji mund të aplikohen edhe këtu në mënyrë respektive. Një pikë me rëndësi ka të bëjë me mungesën e personelit të rregullt mësimor. Duke qenë se personeli mësimor ofrohet në masën deri 90% nga institucionet partnere brenda Kosovës dhe jashtë saj, personel që përdor koncepte didaktike të ndryshme, do të ishte mëse e nevojshme që të bëhet një unifikim (bashkërendim) që të krijohet një koncept didaktik i përbashkët në nivel të UGJ.

- **A është në përputhje me standardet ndërkombëtare diploma akademike?**

Në përgjithësi, po. Programet e studimit në masë të madhe janë në përputhje me programet e krahasueshme në vendet perëndimore (evropiane). Është edhe parakusht për zbatim të programit që të ketë >80% të përmbajtjes identike me programet respektive që ofrohen jashtë vendit.

- **A ofron struktura e programit mundësi të mjaftueshme për punë të pavarur studimore, për reflektim dhe analizë? (p.sh. cili është proporcioni i punës së pavarur studimore krahasuar me mësimdhënien online/në distancë kundrejt mësimin në klasa?)**

Koncepti i llogaritjes së kredive ECTS për modulet përfshin një hapësirë të mjaftueshme për ushtrimet, për detyrat e shtëpisë dhe për studime vetanake. Megjithatë, në këtë fazë të hershme të zbatimit të programit, ende mungon përvoja e bazuar në të dhëna empirike. Komentet e bëra për programet e studimeve në Bioteknologji mund të bëhen edhe për këtë program.

- **A është adekuat dhe i arsyetuar caktimi i kredive ECTS?**

Po.

- **A është e përballueshme nga studentët ngarkesa e kërkuar nga programi akademik**

Në përgjithësi dhe duke u bazuar në materialet e ofruara, po. Megjithatë, është tepër herët që të komentohet në mënyrë gjithëpërfshirëse e kuptimplotë në lidhje me këtë pyetje. Diskutimet me studentët do të ishin të nevojshme për të

indikuar nëse ka (potencialisht) disbalans dhe/ose ngarkesë të tepërt. Komentet e bëra për programin në Bioteknologji mund të vlejné edhe për këtë program.

- **A janë të mjaftueshme për arritjen e synimeve të programit dhe të rezultateve (kompetenca dhe kualifikimet, njohuritë dhe shkathtësitë) metoda e mësimdhënies dhe përmbajtja e njësive mësimore?**

Një parakusht për zbatim të suksesshëm të detyrave është plotësimi i kapaciteteve me personel mësimor të kualifikuar. Rekomandohet fuqimisht që të punësohet person me oara të plotë në UGJ (jo me profesorë me orar jo të plotë që vijnë nga institucionet tjera). Megjithatë, duke qenë se deri tani në Kosovë e as në vendet fqinje nuk ka Arsimit të Lartë në fushën e Pylltarisë, do të mund të jetë e vështirë që të gjendet personel akademik të kualifikuar.

- **A është kuptimplotë dhe transparente mbivendosja e përmbajtjes akademike në mes pjesëve të ndryshme të kurrikulës?**

Disa mangësi sa i përket transparencës u vunë në pah gjatë diskutimeve të zhvilluara gjatë VI, veçanërisht në fushën e moduleve. Siç është sugjeruar edhe për programin e studimeve në Bioteknologji (BSc.) investimet që do të mund të bëheshin në sistemin e mentorëve do të mund të përmirësonin situatën dhe të trajnonin studentët në ngritjen e profileve të duhura në përputhje me synimet e tyre për punësim në të ardhmen.

- **Sa janë në përputhje me standardet ndërkombëtare kriteret dhe procedurat e pranimit?**

Duke qenë se numri i aplikantëve për program qartësisht tejkalon kapacitetet e vendeve të mësimit në dispozicion (rreth 500 aplikantë duhet të plotësojnë 50 vende studimi në dispozicion), atëherë një procedurë e pranimit duhet vënë në funksion. Ko është bërë përmes notave të vlerësimit prej testeve në shkollë, si dhe nga niveli i njohjes së gjuhës angleze dhe përmes testimit në lëndët që kanë të bëjnë me pylltarinë dhe në njohuritë e matematikës, si dhe letrës motivuese, kjo e fundit indikon pritshmëritë personale të studentëve. Kjo është plotësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare.

- **A është adekuat raporti numerik në mes personelit akademik/artistik dhe studentëve?**

Në përgjithësi po. Raporti numerik në mes personelit akademik dhe studentëve është adekuat dhe mundeson të gjitha format e qasjes didaktike. Megjithatë, siç është cekur më parë, ka një mungesë të personelit akademik që është punësuar nga UGJ me orar të plotë. Ky raport numerik duhet zgjeruar sa më parë dhe si rrjedhojë të zvogëlohet numri i personelit vizitues dhe nga institucionet fqinje.

Komentet e bëra për programin në Bioteknologji mund të vlejné edhe për këtë program.

3. Personeli

- **A ka institucioni proporcion adekuat të personelit të rregullt dhe proporcion të duhur në mes personelit të rregullt dhe atij të jashtëm?**

Jo aspak. Siç u cek më lart, tani gati 500 aplikime mbulojnë rreth 50 vende studimi në nivelin BSc. Tani për tani rreth 90% e profesorëve nuk kanë punësim të rregullt në UGJ, por merren në bazë të punës me honorar nga institucionet partnere. Duket që nuk ka personel tjetër mësimor përveç profesorëve vizitues. Mbi këtë bazë është vështirë që të krijohet dhe të zhvillohet më tej një program studimesh në mënyrë të qëndrueshme, që do të plotësonte standardet e larta dhe do të kontribuonte në konceptin didaktik gjithëpërfshirës.

- **A demonstroi personeli akademik aftësi në nivel të lartë akademik dhe didaktik dhe a janë kualifikimet e tyre adekuate me pozitën që ata i mbajnë brenda institucionit në përputhje me kriteret bazë?**

Sipas kriterëve ekzistues (të kufizuara) për punë kërkimore dhe pjesëmarrje në rrjetet ndërkombëtare, në shoqatat shkencore dhe në konferencat ndërkombëtare, atëherë kualifikimet e personelit duket se janë të mjaftueshme. Megjithatë, ky personel duket se nuk është i lidhur me institucionin që është nën vlerësim në bazë të kontratave me orar të plotë, atëherë kjo vështirësi që mundëson krijimin e projekteve hulumtuese që so të ofronte përmbajtje të fjalës së fundit për programet mësimore. Komentet e bëra për programin në Bioteknologji mund të vlejné edhe për këtë program.

4. Hulumtimet dhe Bashkëpunimi ndërkombëtar

- **A është i përfshirë në aktivitetin hulumtues personeli mësimor brenda ose jashtë institucionit dhe a janë të ndërlidhura me procesin mësimor/përmbajtjen e lëndëve mësimore këto aktivitete hulumtuese?**

Duke qenë se deri tani nuk ka gati fare personel të rregullt akademik që është punësuar nga UGJ, nuk ka as përfshirje në hulumtime e që janë të ndërlidhura me UGJ në fushën e Pylltarisë. Komentet e bëra për programin në Bioteknologji mund të vlejné edhe për këtë program.

- **A janë adekuate shtrirja dhe cilësia e bashkëpunimit ndërkombëtar në hulumtime dhe mësimdhënie?**

Sa i përket pohimeve të cekura më sipër ka një potencial të ndjeshëm që nuk është shfrytëzuar dhe që do të mund të shfrytëzohej përmes caktimit të resurseve

të nevojshme. Prioritet i parë dhe parakusht do të ishte punësimi i personelit mësimor në bazë permanente që në anën tjetër do të ishte në gjendje që të krijonte dhe të mbështeste kontaktet ndërkombëtare si dhe aktivitetet hulumtuese

- **A janë të përfshirë studentët në projekte hulumtuese dhe të bashkëpunimit?**

Duke qenë se tani për tani nuk ka studentë në semestra të avancuar dhe duke qenë se nuk ka gati aspak aktivitete hulumtuese në fushën e bioteknologjisë, nuk ka as përfshirje të studentëve në hulumtime. Si rrjedhojë, ka poashtu një mungesë sa i përket projekteve interdisciplinare dhe ndërkombëtare.

5. Financat dhe Infrastruktura/Mjediset dhe Pajisjet

- **A ka institucioni një plan buxhetor adekuat?**

Në përgjithësi, po, por fondet që janë në dispozicion nuk janë definuar në mënyrë të qartë organeve akademike të Universitetit dhe janë larg të qenit të mjaftueshme për një mësimdhënie dhe hulumtime progresive që është e orientuar drejt së ardhmes. Duke qenë se institucionet publike shtetërore ofrojnë shumicën e vendeve të punës të lira për të diplomuarit nga Programi i Studimeve në Pylltari, ato institucione do të mund të ishin të interesuara për të zhvilluar projekte hulumtuese në Universitet dhe për të ofruar fondet financiare respektive.

- **A ka institucioni ndërtesa adekuate dhe infrastrukturë të specializuar për kërkesat e programit?**

Kapacitetet sa i përket ndërtesave dhe cilësisë duket se janë të mjaftueshme. Komentet e bëra për programin në Bioteknologji mund të vlejné edhe për këtë program. Planifikohet të ketë infrastrukturë të re sa i përket ndërtesave që do t'i vihen në dispozicion Fakultetit të Shkencave Aplikative dhe ato do të jenë në dispozicion të programeve të studimit që janë në vlerësim.

6. Menaxhimi i Cilësisë

- **A vlerësohen programet e institucionit në bazë të rregullt brenda kontekstit të proceseve të brendshme të vlerësimit?**

Përmbledhje e përgjithshme e vlerësimit

Po. Vlerësimi ndodh në baza të rregullta përmes pyetësorëve për studentë për vlerësimin e lëndëve mësimore dhe mësimdhënësve. Veç kësaj, bëhen edhe vlerësime dhe procedura të akreditimit që ndodhin në bazë të rregullt nga jashtë dhe në mënyrë të pavarur.

Përmbledhje e përgjithshme e vlerësimit

Në përmbledhje të vërejtjeve të cekura më lart, mund të jepen rekomandimet në vijim për ngritje të mëtejme të programit:

- Më e rëndësishmja është që të punësohet në bazë të rregullt personel mësimor, që do të zëvendësonte një pjesë të personelit me orar jo të plotë dhe që do të krijonte një bazë afatgjatë dhe të qëndrueshme për përmirësimin e strukturave gjithëpërfshirëse mesimdhënëse dhe do të mundësonte krijimin e aktiviteteve hulumtuese.
- Vazhdimi dhe konsolidimi i strukturës së tanishme të moduleve dhe veç kësaj do të duhej të eksplororeshin dhe të inkorpororeshin fushat e reja dhe temat e reja në programet e studimit.
- Caktimi i fondeve financiare shtesë dhe burimeve të kërkuara për fillimin dhe mbështetjen e aktiviteteve hulumtuese, veçanërisht ka nevojë për aktivitet hulumtues në nivel interdiciplinar dhe ndërkombëtar. Është afër mendsh që kërkesa nga tregu i punës për të diplomuar nga ky program studimesh do të jetë mjaft e lartë brenda një afati të mesëm dhe afatgjatë. Personeli mësimor dhe të diplomuarit e nivelit master do të duhej të josheshin përmes mundësive për të përfunduar PhD jashtë vendit, kjo do të duhej të ishte një parakusht urgjent për të zëvendësuar personelin e tanishëm akademik dhe të plotësoheshin pozitat akademike me kandidatë cilësorë. Do të duhej krijuar një model publik privat (të Pyltarisë) për të mbështetur hulumtimet aplikative.
- Do të duhej të mundësoheshin dhe të intensifikoreshin shkëmbimi ndërkombëtar si dhe pjesëmarrja e dhënia e kontributit në takimet ndërkombëtare shkencore, jo vetëm në ndonjë projekt, por në bazë të rregullt dhe të përhershme; kjo kërkon personel të rregullt akademik që do të ishte i ndërlidhur me UGJ siç është cekur tashmë disa herë.
- Duhet të zbatohet dhe të përdoret një platformë e unifikuar e të mësuarit në mënyrë që të përmirësojë komunikimin (veçanërisht komunikimin e studentëve) dhe që do të mundësonte forma të reja didaktikë të të mësuarit si dhe qasje nga distanca si dhe aktivitete të mësimin në distancë. Kjo duhet të zhvillohet në nivel të Universitetit, duke përfshirë gjithë Fakultetet dhe programet e studimit.
- Duhet të krijohet një rrjet i studentëve të mëparshëm që kanë përfunduar studimet dhe të mirëmbahet në baza të rregullta dhe afatgjatë; anëtarët e një rrjeti të tillë do të mund të ofronin informata në lidhje me kërkesat e tregut të punës dhe nevojat për ndryshim në programet e studimit. Veç kësaj, ata do të mund të ofronin informacion në lidhje me përvojat e fituara nga puna praktike, dhe do të mund të përfshiheshin në përpjekjet për sigurim të fondeve të financimit.
- Disa çështje nga skema e vlerësimit nuk mund të adresoheshin ose janë adresuar në mënyrë të pjesërishtme duke qenë se ka një përvojë shumë të kufizuar ose nuk ka përvojë fare si rrjedhojë e fazës së hershme të zbatimit të programit të studimeve. Për këtë arsye, një vlerësim në vijim do të duhej të

zhvillohej pas një viti, maksimum dy vjetësh në mënyrë që të bënte të dukshëm dhe të matshëm progresin e arritur në shumë aspekte.

Rekomandimet

- Të mos bëhet akreditimi në këtë formë të tanishme.
- Kjo në masë të madhe është si rrjedhojë e një gjendje jo të sigurt sa i përket personelit akademik të rregullt e që është i ndërlidhur me këto programe.
- Duhet të dorëzohet përsëri një aplikim pasi të jenë bërë ndryshimet sa i përket pikave kritike dhe zbatimit të rekomandimeve të dhëna në këtë raport vlerësimi.

Prof. Dr. sc. agr. Reiner Doluschitz
Universiteti i Hohenheim, Shtutgart, Gjermani
Intituti i Menaxhimit të Fermave

3.5 Bachelor in ‘Marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe Studimet e BE’

Prof. Dr. Frederic Mertens de Wilmars

Raporti ynë është i mbështetur në:

- dokumentet e dorëzuara para vizitës sonë
- takimet gjatë vizitës
- dokumentet e kërkuara pas vizitës

1. Vërejtjet e përgjithshme dhe rekomandimet në lidhje me universitetin

Vërejtjet tona kanë të bëjnë me shqyrtimin e dokumenteve të dërguara nga ana e UGJ “Fehmi Agani” përmes AAK si dhe nga takimi me stafin menaxherial senior në këtë Universitet më 12 maj 2015.

Duke u mbështetur në informacionin e marrë, pikat e vërejtura sa i përket UGJ sjellin në pah tri aspekte që do t’i theksonim (pa përjashtuar të tjerat): (1) krijimi i një universiteti dhe ndikimi i tij në rajon (2) struktura dhe organizimi i tij (3) marrëdhëniet e tij të jashtme.

1.1. Themelimi dhe ndikimi i universitetit në rajon

Është e vërtetë që çështja e themelimit dhe ndikimit UGJ “Fehmi Agani” në rajon nuk është temë e shqyrtimit në këtë raport, megjithatë ne besojmë që kjo çështje duhet të merret parasysh duke qenë se arsyeshmëria e universitetit dhe e programeve të tij të studimit varet nga faktori i krijimit dhe nga faktori socioekonomik dhe i punësimit në rajon.

UGJ “Fehmi Agani” gjendet 90 km nga Prishtina, një orë larg me makinë, është në një rajon rural dhe si rrjedhojë të pazhvilluar. Qendra urbane dhe rrethina ku gjendet Universiteti ka 90 000 banorë, megjithëse menaxhmenti senior i Universitetit na njoftoi që brenda kufinjëve të komunës jetojnë rreth 300 000 banorë. Lidhjet e dobëta rrugore me qytetet e rëndësishme (mes tjerash me Prishtinën) mund të paraqesin një hendikep sa i përket punësimit të personelit të rregullt (me orar të plotë) dhe për tërheqjen e studentëve nga rajonet tjera.

Sa i përket infrastrukturës së jashtme të universitetit (strehimit, etj) UGJ “Fehmi Agani” luan një rol të rëndësishëm në zhvillimit të tij duke qenë se ka potencialin për t’u bërë një pikë zhvillimi dhe pune në rajon.

Me rezervat sa i përket një analize më të thellë dhe finale të planit strategjik të UGJ “Fehmi Agani” që nuk e dijmë dhe që nuk mund të kujtohet nga Menaxhmenti Senior i Universitetit gjatë vizitës së zhvilluar, ne rekomandojmë që ky të përpilojë një politikë të sinergjisë dhe të koordinimit të zhvillimit lokal/rajonal me hisedarët në rajon (ata ekonomikë, socialë, politikë, zyrtarët administrativë, kulturalë, etj).

1.2. Struktura e Universitetit dhe Organizimi

Sa i përket strukturës së universitetit dhe organizimit, ne vërejtëm që (kjo bazuar në dokumentet e ofruara dhe në takimet e zhvilluara) UGJ “Fehmi Agani” tenton që të jetë në përputhje me standardin e Kornizës Evropiane të Arsimit dhe të Programit Mësimor, megjithëse na duhet të theksojmë disa elementë për sqarim dhe përmirësim.

1.2.1. Skema organizative

Skema organizative dhe elementet janë në përputhje me organizimin e Universiteteve Evropiane megjithëse është një përmbledhje e përshkrimit të funksionit dhe e përbërjes së secilit element në skemën organizative. Ne nuk kuptojmë procedurën e emrimit të ekipit të rektorit dhe të dekanëve. Veç kësaj, nuk e dijmë se kush e përbën Komitetin Drejtues (kush është përgjegjës për të përgatitur planin strategjik të UGJ) cilat janë aktivitetet e sigurimit për planifikim të cilësisë? Informatat e dorëzuara kanë mangësi sa i përket transparencës dhe saktësisë.

Rekomandim:

Kërkohet më shumë saktësi dhe informata sa i përket përbërjes, ofrimit të secilit element të organizimit të UGJ, si dhe procedurës për emrimin e anëtarëve menagjerialë dhe atyre me poste të larta.

1.2.2. Autonomia institucionale dhe akademike

Mungon ose është i paqartë informacioni i ofruar në lidhje me këtë aspekt. Është e nevojshme që të specifikohet se në çfarë mase UGJ “Fehmi Agani” ka krijuar një autonomi të caktuar institucionale dhe akademike. Ne nuk kemi asnjë informacion në lidhje me garancitë në këtë drejtim, për më tepër në lidhje me çështjen e marrëdhënies financiare në mes të fuqisë publike të Shtetit të Kosovës dhe UGJ “Fehmi Agani”.

Rekomandim:

Të publikohet informacioni sa i përket:

1.2.3. Aspektit Financiar

Bazuar në dokumentet e ofruara dhe intervistës me Menaxhmentin Seniorë të UGJ, ne morëm vesh që burimi kryesor i financimit vjen nga shteti, edhepse Komuna e Gjakovës duket se merr pjesë në mbështetje sa i përket infrastrukturës së UGJ. Megjithatë, edhe përkundër rekomandimeve të dhëna në raportin paraprak të majit 2014, RVV nuk cek në mënyrë të qartë kornizën financiare të UGJ “Fehmi Agani”. A pranohen tashmë nga UGJ fondet e jashtme? Cila është rëndësia e këtyre burimeve të jashtme (shembull, roli i Bashkimit Evropian ose i Bankës Botërore Islamike?)

Rekomandim:

Kërkohet më shumë transparencë në lidhje me këto informata, duke qenë se janë të rëndësishme sa i përket të qenit të dukshëm për UGJ. Poashtu kjo mundëson një mendimi të qartë në lidhje me arsyeshmërinë financiare të programit edukativ. Për shembull, si mund t'i mbulojë shpenzimet e studentëve (grantet), shpenzimet e shkëmbimit (Erasmus, etj).

1.2.4. Infrastruktura dhe Pajisjet Kompjuterike

Bazuar në informatat e cekura në RVV dhe VI në UGJ, infrastruktura duket të jetë shumë bazike dhe jo adekuate për një shkollë mjekësore. Ato mund të jenë adekuate për mësimdhënie teorike, por sa i përket infrastrukturës të shfrytëzuar për investigim, ato duket të jenë modeste dhe nuk funksionojnë si duhet.

Në bibliotekë ne nuk patëm mundësi t'i shohim të gjitha, por tekstet në lidhje me shkencat mjekësore dhe shkencat sociale ishin mjaft të varfra që t'i plotësojnë nevojat e studentëve dhe hulumtuesve.

Rekomandim

UGJ “Fehmi Agani” do të duhej të bënte investime të ndjeshme në renovimin e ndërtesave që shfrytëzohen për mësimdhënie dhe punë hulumtuese. P.sh. ne sugjerojmë që do të duhej të kishte një kompjuter me lidhje në internet në secilën sallë, një ekran dhe një projektor.

Ne poashtu rekomandojmë që UGJ “Fehmi Agani” do të duhej të bënte investime po aq substanciale dhe prioritare në ngritjen e një biblioteke të centralizuar dhe të organizuar sipas standardeve ndërkombëtare të bibliotekave.

Gjendja e tanishme në lidhje me bibliotekën nuk është efikase. Veç kësaj, materiali kompjuterik i studentëve nuk ka arsyen e vet “të ekzistimit”. Ky material duhet t'i transferohet bibliotekës.

1.2.5. Personeli Akademik dhe ai Administrativ

Siç kanë cekur edhe raportet paraprake që i pranuan nga AAK, ne vërejmë një raport numerit shumë të madh të mësimit më orar jo të plotë ose atyre të asocuar në raport me profesorët e rregullt. Ne kuptojmë që kjo gjendje mbetet e tillë si rrjedhojë e tranzicionit nëpër të cilin po kalon UGJ. Megjithatë, nëse synohet që të ketë aktivitete arsimore të qëndrueshme, nuk është adekuate që kjo gjendje të vazhdojë në menaxhimin e departamenteve të fakulteteve, poashtu edhe sa i përket punës hulumtuese.

Sa i përket procedurës së pranimit të personelit dhe vlerësimeve të vazhdueshme të personelit akademik, ne vërejmë që UGJ nuk ka saktësuar mirë procedurën vjetore të vlerësimit. Veç kësaj, nuk është specifikuar se kush do ta bëjë këtë vlerësim (AAK, ekspertët lokalë apo ata të jashtëm, etj).

Sa i përket çështjes së barazisë gjinore, personeli universitar (ai administrativ dhe akademik) në masë të madhe janë meshkuj. Ne kuptuam gjatë intervistës me Menaxhmentin Seniorë të UGJ që ky i fundit nuk ka një politikë në lidhje me barazinë gjinore brenda kornizës akademike.

Rekomandim:

- *Duhet të ketë transparencë nga UGJ në lidhje me procedurën e vlerësimit të vazhdueshëm të personelit (kriteret, metodën e vlerësimit, identifikimin e vlerësuesve, etj).*
- *Duhet të ketë një politikë të UGJ që është efektive dhe specifike ndaj përfaqësimit më të madh të femrave në mesin e personelit mësimit, në punë kërkimore dhe në pozitat me përgjegjësi (të paktën një 30%).*

1.3. Marrëdhëniet e jashtme të Universitetit

Marrëdhëniet e jashtme të UGJ në parim kanë të bëjnë me iniciimin, konsolidimin dhe zhvillimin e programeve akademike të veta. Raportet janë tri llojesh: me entitetet publike dhe ato private, me universitetet e Kosovës dhe me raportet ndërkombëtare.

1.3.1. Me organizatat publike dhe private

Ne kemi vërejtur që UGJ është duke u përpjekur të fillojë bashkëpunimet dhe marrëveshjet me institucionet publike dhe private, mes tjerash për t'i mundësuar studentëve të vetë që të kenë mundësi për punë në terren.

Rekomandim

UGJ duhet të intensifikojë marrëdhëniet përmes marrëveshjeve formale me zyrtarët socioekonomikë dhe publikë në rajon, kjo në mënyrë që të jetë në gjendje për të

zhvilluar sinergji në fushat e mësimdhënies dhe të hulumtimeve shkencore (cfr, supra 1.1).

1.3.2. Me Universitetet tjera në Kosovë

Prej intervistës me Menaxhmentin Seniorë të UGJ, ne kuptuam që ka bashkëpunim me UP sa i përket faktit që shumë nga mësimdhënësit e UGJ në fakt vijnë nga UP. Megjithatë, ne nuk kemi arritur të kuptojmë dinamikën e vërtetë të UGJ “Fehmi Agani” me universitetet tjera publike dhe private. Është e natyrshme që kjo do të duhej të definonte pozitën në lidhje me universitetet tjera, por do të ishte adekuate që të krijoheshin partneritete me UP dhe që ky të fillojë të jetë pjesë e rrjetit kosovar të universiteteve që të krijojë një lloj singulariteti në skenën universitare në Kosovë.

Rekomandim:

Duhet të ketë një intensifikim të marrëveshjeve të bashkëpunimit me UP (dhe me universitetet tjera të rëndësishme) dhe krijim të udhëheqjes me universitetet tjera në rrjetin universitar me qendrat tjera publike e private.

1.3.3. Marrëdhëniet Ndërkombëtare

UGJ “Fehmi Agani” ka bashkëpunim me organizata ndërkombëtare dhe universitete të jashtme.

Rekomandim:

Një intensifikim më i madh i këtij lloji të marrëdhënieve në mënyrë që të ofrohet një vizibilitet më i madh dhe një përafrim me standardet ndërkombëtare. Prioritare duhet të jenë mësimdhënia dhe shkëmbimi i hetuesve.

2. Vërejtje në lidhje me programin Akademik “Marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe Studimet e BE” dhe rekomandimet

Raporti është i mbështetur në dokumente që janë dorëzuar paraprakisht para vizitës dhe të dorëzuara edhe më pastaj sipas kërkesës.

2.1. Struktura e Programit

Struktura e programit akademik në vetvete duhet të jetë arsye e analizës sa i përket pjesëve organizative, didaktike, cilësore, metodike. Më pastaj, ne do të shqyrtojmë përmbajtjen.

2.1.1. Ndërlidhja e programit me misionin e universitetit dhe me parimet e punës.

Programi “Marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe Studimet e BE” në aspekt global është në përputhje me misionin dhe me fillimin e operimit të Universitetit megjithëse mungojnë disa shpjegime dhe informata bazë siç janë vlerësimi i punëve praktike, përmbajtja e programit, organizimi i mësimit në distancë. (Nuk ka Informacion!).

Përshkrimi i RVV dhe intervistat janë shumë të përgjithësuara në raport me rezultatet e mësimit që duhet t'i marrin studentët.

Rekomandimet:

- *Një saktësi më e madhe në lidhje me vlerësimin e punës në terren (rëndësia e notave, kur duhet të bëhet notimi, etj)*
- *Një përshkrim më i detajuar në lidhje me procedurën e mësimit në distancë*
- *Një përshkrim më të detajuar dhe të precizuar në lidhje me rezultatet e mësimit të kërkuara nga studentët.*

2.1.2. Përshatja e programit me diplomën akademike (cilësinë, synimet akademike)

Varësisht nga niveli, cilësia e programit është e mjaftueshme sa i përket vetë programit akademik, kjo sa i përket ndërlidhjes së teorisë dhe praktikës (megjithëse përshkrimi nuk duket të jetë i mjaftueshëm), karakteri interdisiplinar i programit dhe fakti që studentët e pranuar në program tashmë kanë trajnime paraprake në lëndët mësimore të programit.

Megjithatë, përshatja e programit me nivelin akademik do të jetë pozitive me kushtet në vijim:

- reformimi i disa apekteve të përmbajtjes së programit,
- Mundësia e zgjatjes së programit me veçantitë e caktuarapër të bërë një program më të specializuar
- Specifikimi i modaliteteve të të mësuarit në distancë.

2.1.3. Përshkrimi dhe marrja e personelit të përshatshëm për konceptin didaktik të programit

Theksi i vënë në lidhjen në mes aspekteve praktike dhe teorike të programit është evident si dhe në dimensionin interdisciplinar.

Megjithatë, siç e kemi cekur më parë, ne duhet të kemi më shumë informacion sa i përket organizimit të punës praktike. Nuk ka shpjegime konkrete në lidhje me

metodologjinë e mësimdhënies (janë dhënë në mënyrë shumë të përgjithësuar) edhe në nivelin e procedurës didaktike.

Duket se është ofruar një punë obligative individuale. Një punë individuale në fund të studimeve duket se është paraparë, edhe mësimdhënia e metodologjisë hulumtuese.

Rekomandimet:

Elaborimi i një udhëzuesi të plotë në lidhje me:

- *Organizimin, metodologjinë, vlerësimin, monitorimin e secilës pjesë të punës praktik;*
- *Metodologjia dhe puna kërkimore e secilit anëtar të personelit*
- *Caktimi i punës individuale (si tezë)*

2.1.4. Përputhja e nivelit akademik me standardet ndërkombëtare

Nga pikëpamja komparative, programi është në përputhje me standardet ndërkombëtare, por duke i konsideruar ato si program bazik. Duhet të përmirësohet metodologjia dhe prezantimi i mundësive për të bërë karrierë në Kosovë.

Programi duket se është shumë bazik, që t'i prezantojë studentëve në mënyrë direkte organizatat ndërkombëtare. Duhet të ketë mësim shtesë specifik.

2.1.5. Mundësia që studentët të ndërmarrin studimet, reflektimet dhe analiza autonome

Përtej deklaratimit të synimeve të programit, nuk ka asgjë tjetër që të shpjegojë qoftë në materialet e kërkuara dhe të dorëzuara, por poashtu edhe në intervistat e bëra nuk ka informacion në lidhje me kushtet e ndërlidhura me punën e pavarur të mundshme të studentit.

Veç kësaj, nuk ka indikacion të qartë në lidhje me llojin e punës së bazuar nga shtëpia që i kërkohet studentit ta bëjë.

Në anën tjetër, gjatë takimit, menaxherët e programit na thanë që elementet bibliografike janë përdorur për studimet e studentëve. Në përgjithësi, këto duket të jenë modeste për ne dhe nuk janë në përputhje me evoluimin e integriteteve evropiane, mes tjerash.

Ne kemi cekur më parë në pikën 2.1.3 nevojën për të futur punën individuale të një madhësie të caktuar (në formë të tezës): 45000 karaktere. Ne rekomandojmë këtë lloj pune në vitin e fundit (në dy semestret e fundit) me një mbikqyrje në formë tutori të përhershme dhe të individualizuar.

Ne poashtu rekomandojmë:

- *Shpjegimin e udhëzimit në lidhje me punën e bazuar në punë dhe drejtuar profesorëve dhe studentëve, si dhe një bibliografi më të plotësuar dhe më të fundit në mënyrë që të ofrohen detyra për studime të pavarura.*

2.1.6. Përshtatja e kredive ECTS

Nuk mjafton nëse puna në terren është e përfshirë në kreditë ECTS. Për më tepër, vëllimi i ECTS për vit (60) duket se është i pamjaftueshëm në krahasim me lëndët mësimore të caktuara, përveç nëse ato nuk mbulojnë pjesërisht përmes mësimave teorike. Ne rekomandojmë përshtatjen e numrit të gjithmbarshëm të kredive ECTS duke e ngritur atë, që të bëhen 80 ECTS në vit, të paktën.

2.1.7. Vëllimi i punës së studentëve

Në parim, programi është plotësisht i përballueshëm nga ana e studentëve, edhe pse nuk ka një prezantim të agjendës për secilën lëndë mësimore.

Në anën tjetër, sipas vëllimit të orarit javor, studentët kanë vetëm një orë punë nga shtëpia dhe 15 orë në universitet, që duket se është pak reale duke pasë parasysh lëndët mësimore që janë në programin “Marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe Studimet e BE-së”.

Rekomandim: të rregullohet vëllimi javor i aktiviteteve varësisht nga lëndët mësimore, të ketë më shumë aktivitete të pavarura për studentë (të paktën 4 orë/javë) dhe më shumë orë nën mbikqyrje nga tutorët për secilin student (në mes 2 dhe 3 orë/student).

2.1.8. Përshtatshmëria e kriterëve dhe procedurave të pranimit me standardet ndërkombëtare

Kriteret e pranimit duket se janë përshtatur ndaj standardeve ndërkombëtare.

Megjithatë, ne rekomandojmë që programi do të duhej të kishte si parakusht njohjen paraprake të gjuhës angleze, të paktën në nivelin fillestar, duke qenë se shumë materiale të studimit siç janë manualët, revistat, burimet e informacionit të organizatave ndërkombëtare dhe të Bashkimit Evropian janë të publikuara në anglisht. Lëndët në gjuhën angleze duhet të shërbejnë për përmirësimin dhe perfeksionimin e njohjes dhe ushtrimit të gjuhës.

Ne poashtu sugjerojmë që studentëve t’iu ofrohet mundësia e një gjuhe të dytë, përveç anglishtes.

2.2. Metodologjia e mësimdhënies: aspektet tjera

Sa i përket metodologjisë së mësimit, ne tashmë kemi komentuar disa aspekte në paragrafët paraprakë. Megjithatë, ka modalitete që janë lënë menjanë e që në mënyrë të logjikshme do të duhej të ishin në metodologjinë e mësimdhënies (2.2.1) si dhe përpjesa personale akademike e programit (2.2.2).

2.2.1. Të mësuarit me orar të plotë/me korrespondencë/në distancë

Programi akademik parasheh që 100 studentë të ndjekin studimet e rregullta dhe 40 me korrespondencë. Në anën tjetër, cek edhe mësimin në distancë.

Nëse në trajnimin e rregullt është përshkruar dhe të paktën është e kuptueshme koha e kaluar, në lidhje me trajnimin me korrespondencë nuk ka tregues dhe aspekte metodologjike që janë të ndërlidhura me këtë modalitet të trajnimit. As ne nuk kemi pasur tregues sa i përket trajnimit në distancë. A mund t'i shërbejë gjithë llojeve të studentëve ose vetëm atyre që janë me korrespondencë?

Rekomandim:

- *Të përfundohet përshkrimi i metodologjisë së mësimdhënies për studentët me korrespondencë*
- *Të përfundohet përshkrimi i metodologjisë së mësimdhënies për mësim në distancë dhe të precizohet se kush mund t'i nënshtrohet kësaj mënyreje të të mësuarit.*

2.2.2. Raporti numerik në mes personelit akademik/studentëve

Thënë në përgjithësi, proporcioni numerik në mes personelit akademik dhe studentëve është i mjaftueshëm.

Megjithatë, pas ekzaminimit të profilit të pozitive/posteve të secilit profesor, ne kemi vërejtur që raporti numrik i mësimdhënësve të rregullt ose me orar të plotë është disi i zvogëluar. Në këtë program kjo situatë kjo mund të shpjegohet në atë që të mos ketë mësimdhënës në dispozicion në raport me nevojat e studentëve (për përcjellje të punës kolektive dhe asaj individuale, për mbikqyrje si tutor, etj) dhe vetë aktiviteve të programit ose universitetit (duke përfshirë edhe hetimin shkencor)

Rekomandim:

- *Të parashihet që të ketë të paktën 20% të personelit me orar të plotë*
- *Të parashihen 2% e personelit për mësim në distancë.*

2.3. Përmbajtja e programeve akademike

2.3.1 Përmbajtja e raportit me synimet e programit

Thënë në përgjithësi përmbajtja e programit duket të jetë adekuate me synimet e programit, edhe pse ne rekomandojmë që të bëhen disa ndryshime dhe të ofrohen disa shpjegime sa i përket transparencës dhe qartësisë së gjithë përmbajtjes.

Rekomandim:

- *Që në mënyrë sistematike të indikohet secila temë e lëndës mësimore*
- *Të indikohen në mënyrë të qartë rezultatet e mësimit*
- *Të përditësohet plotësisht bibliografia (literatura)*
- *Të ketë të paktën tri referenca në anglisht!!!*
- *Referenca elektronike.*

2.3.2. Përmbajtja e lëndëve: rekomandimet e veçanta

a) **Anglishtja:** ne rekomandojmë që përveç lëndëve në anglisht, studentët duhet të kenë një lëndë në anglisht sa i përket integriteteve evropiane, kjo gjatë semestrit të fundit në mënyrë që studentët të familiarizohen me terminologjinë legale evropiane.

b) **Organizatata ndërkombëtare:** të shtohen OSBE dhe Këshilli i Evropës!

c) **Filozofia Moderne:** Të vihet fokus mbi filozofinë politike dhe filozofinë e së drejtës.

d) **Të drejtat e njeriut:** Kërkohet një temë për të drejtat e njeriut sepse ato paraqesin bazën për organizatat siç janë OKB, Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian, si dhe ato paraqesin bazat për sundimit e ligjit.

2.4. Personeli Akademik

Ne kemi vëzhguar aspektet e ndryshme:

a) Vetëm disa profesorë janë me orar të plotë në këtë program, kjo mund të ketë ndikim negativ në përpilimin e përmbajtjes dhe sa i përket punës hulumtuese. Raporti numerik i personelit të jashtëm është shumë i rëndësishëm në mënyrë që të garantohet vazhdimësia dhe rritja cilësore e programit akademik. Në këtë mënyrë, ne rekomandojmë që të ketë një rritje të numrit të mësimeve të rregullt.

b) Menaxheri i programit duhet të jetë një profesor i rregullt me orar të plotë, i rrjedhshëm në studimet në anglisht ose të ketë përvojë jashtë vendit (nga një vend i BE) dhe të ketë numër të ndjeshëm të publikimeve.

c) Sa i përket nivelit akademik dhe aftësive të secilit mësimdhënës, ne kemi vështirësi që të kuptojmë se kush është përgjegjës për secilën lëndë. Ne nuk kemi një listë të qartë të tyre me CV të detajuara dhe me publikimet e tyre.

Megjithë këtë vështirësi, ne mendojmë që në mësimdhënien dhe hulumtimet sa i përket studimeve të BE, sa i përket profilit shkencor dhe akademik të mësimdhënësve, gjendja e personelit mundet dhe duhet të jetë më e mirë në të ardhmen e afërt.

Në anën tjetër, nga aspekti gjuhësor, është problematik fakti që vetëm një person nga grupi flet anglisht, kurse programi ka synimin që të japë mësim në lëndë ndërkombëtare. Në afat të shkurtër dhe të mesëm, studentët mund të përfundojnë në një situatë frustruese pa personel që flet mirë anglisht

d) Sa i përket mësimdhënësve femra, ato mungojnë dhe sipas dokumenteve të lëshuara pas vizitës sonë, korniza hulumtuese përfshin çështjen e gjinisë në terma të përgjithshëm dhe në ata të drejtave të njeriut.

Rekomandim:

- *të përpilohen më shumë publikime të përbashkëta dhe individuale;*
- *Që të ketë trajnime të bindshme në shtetet e BE me qëndrim në universitetet evropiane*
- *Që të ketë trajnim intenziv sa i përket anglishtes (dhe anglishtes legale) për mësimdhënësit;*
- *Që të pranohen dhe të trajnohen të paktën dy mësimdhënëse gra, si dhe të promovohet hetimi dhe punimi i tezës për studentët.*

2.5. Programi i hetimit

Pas takimit, Shkolla e Shkencave Sociale ka dorëzuar planin e hulumtimeve të bazuar në katër tema: Integritet evropiane, të drejtat e njeriut, çështjet sa i përket pakicave dhe gjinisë dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.

Përshkrimi i këtyre katër temave është shumë i përgjithësuar. Secila çështjet për hulumtim duhet të ketë një proces të maturimit. Kjo as nuk indikon për mundësitë e punës hulumtuese të nivelit të doktoratës. Ne poashtu kujtojmë që mungojnë akademikët me profil të konsoliduar mjaftueshëm për të mbështetur këto punë hulumtuese që do të merrnin përsiper drejtimin dhe orientimin e temave të cekura më sipër.

Rekomandim:

- *Shpjegim të planit hulumtues për secilën temë hulumtimi (synimet, metodologjia, ndikimi, materiali, mjetet financiare dhe ato njerëzore, etj) dhe vendi i trajtimit të çështjeve konkrete që duhet të hetohen.*

- *Programet atraktive për studentët që janë të gatshëm që të punojnë në tezën e doktoratës dhe integrimi gradual i këtyre studentëve në ekipet hulumtuese.*
- *Të shqyrtohet mundësia e punësimit të personelit të jashtëm mbështetës për punë kërkimore dhe për programin e mësimit.*
- *Bashkimi me grup të hulumtuesve të udhëhequr nga universitetet tjera në mënyrë që të plotësohet puna hulumtuese ekzistuese në Kosovë..*

2.6. Bashkëpunimi dhe marrëdhëniet ndërkombëtare

Ne kemi vërejtur që Shkolla e Shkencave Shoqërore ka filluar procesion e krijimit të marrëdhënieve ndërkombëtare, është përqendruar në katër marrëveshje bashkëpunimi me katër universitete në Maqedoni, SHBA dhe dy në Shqipëri.

Megjithëse kjo reflekton një përpjekje, ne e konsiderojmë si të pamjaftueshme për shkak se BE ka nevojë të futet në marrëdhënie ose bashkëpunim: një program të “studimeve të BE”. Kjo marrëdhënie është e rëndësishme në mënyrë që të fuqizohet kredibiliteti i programit, të krijohen sinergjitë për mësimdhënie (shkëmbimi i studentëve dhe mësimdhënësve) dhe puna kërkimore (qasja në punë kërkimore dhe vizibiliteti i trajnimit).

3. Përfundimet e ndërmjetme - certifikimi

Ne përfundojmë që Shkolla e Shkencave Sociale dhe UGJ duhet t'i kushtojnë prioritet pikave në vijim, kjo pa paragjykuar gjithë rekomandimet tona:

- Rekrutimi i personelit të rregullt që flet anglisht
- Këshilla nga institucionet dhe organizatat (ndonjëherë të huaja) në mënyrë që të fuqizohen “studimet e BE” dhe cilësia e programit të marrëdhënieve ndërkombëtare.
- Promovimi i barazisë së vërtetë politike.
- Krijimi i një Biblioteke qendrore për secilën shkollë (që do të ndikonte në zvogëlim të shpenzimeve) dhe blerje të databazës që mund të konsultohet nga ana e studentëve dhe hulumtuesve.
- Që të krijohet një rrjet universitar në lidhje me interesimin strategjik, akademik dhe shkencor të UGJ “Fehmi Agani” të programeve akademike.

Bazuar në rekomandimet vëzhgimet tona, ne vlerësojmë që nuk ka as minimum të kushteve për programin të marrë certifikatën e “Studimeve të BE” dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare për tri vjet.

Prof. Dr. Frederic Mertens de Wilmars
Dep. Filosofía de Derecho, Moral y Política
Facultad de Derecho
Universidad de Valencia

3.6 Bachelor në Administratë Publike dhe Bachelor në Shkenca Politike

Prof. Dr. Reinhard Meyers

Raporti preliminar është i ndarë në dy pjesë: pjesa I do të shqyrtojë kushtet e përgjithshme që e karakterizojnë situatën e mësimdhënies dhe të hulumtimit në Fakultetin e Shkencave Sociale si dhe të ofrojë një komentim mbi karakteristikat dhe vëzhgimet që janë të përbashkëta për të trija projektet Bachelor të cekura më sipër; pjesa II do të shqyrtojë secilin nga projektet Bachelor një nga një. Rekomandimet për Fakultetin janë të shkruara më shkronjat *kursiv (italic)*.

3.6.0 Mësimdhënia dhe Puna Kërkimore në Fakultetin e Shkencave Sociale

3.6.01 Organizimi dhe Infrastruktura

EE pohon faktin që Fakulteti është ende në fazën e lindjes së tij dhe është në proces të lëvizjes nga ndërtesa e vjetër në qendër të Gjakovs në një ndërtesë të re në periferi të qytetit. Të dyja ndërtesat u vizituan dhe u panë si të mjaftueshme sa i përket madhësisë, infrastrukturës teknike, akomodimit të studentëve për programet e planifikuara. Në parim duket që ka një mungesë të hapësirës së zyreve për personelin mësimor, kur dhe nëse shifrat e personelit të jenë në nivelin e tyre të paraplanifikuar. Megjithatë, ndërtesa e re ka qasje në internet pa tela, kështu që secili mund të punoj nga kudo që ndodhet; për disa vitet e para të zhvillimit, mund të jenë të nevojshme vetëm disa zyre fikse për punë gjatë orarit të punës dhe për qëllimet e konsultimit me studentë. Në një fazë afatmesme, Fakulteti do të duhej të shqyronte mundësinë e ofrimit të një dhome të përbashkët që do të shërbente për takime për mësimdhënësit akademikë.

Struktura organizative dhe menaxheriale e Fakultetit, siç është specifikuar në RVV f. 256 e në vijim, ishte në përputhje me atë çfarë EE ka vërejtur në mjedisin akademik të vrojtuar. Për fazën e tanishme të fillimit, Këshilli i Fakultetit (f. 256) duket se është disi i fryrë në numër (nëse është i saktë, EE numëruan 41 anëtarë) një numër më i vogël do të mund të përmirësonte shpejtësinë e vendimarrjes. Fakulteti duket se është i gatshëm të ndjek këtë sugjerim.

3.6.02 Biblioteka

Bibliotekën të cilën e vizitoi EE gjatë VI dukej se ishte e pasur me libra mjekësorë, në kontrast me këtë në të mungonin ata të shkencave socialë që sigurisht se nuk do të paraqiste një platformë mbi të cilën do të ngrihej programi i lëndëve mësimore për të cilat është aplikuar akreditimi. Për këtë arsye, një numër i madh

rekomandimesh që nga organizimi i Bibliotekës deri të blerja e literaturës së teksteve shkollore ishte përfshirë në raportin paraprak. Në komentet e tyre sa i përket këtij raporti, UGJ indikoi që ata janë të përkushtuar ndaj zbatimit të shumicës së rekomandimeve të cekura. Për këtë arsye ne e mbajmë këtë çështje vetëm si shënim dhe do t'i referojmë palët e interesuara në raportin preliminar po që se shfaqen përsëri çështje në lidhje me bibliotekën.

3.6.03 Personeli

Fakulteti, bazuar në RVV origjinale (të parë) të dorëzuar në shtator 2014, ka probleme të mëdha sa i përket personelit: nuk ka një anëtar të vetëm të personelit të rregullt që është anëtar në bord, gjithë personat e cekur në listën e stafit të AAK mbajnë të paktën një pozitë të rregullt diku tjetër (më së shumti në Prishtinë), 10 nga 24 personet në atë listë poashtu kanë angazhime me honorar në institucionet tjera, kjo përveç punës së tyre primare që kanë me orar të plotë, e disa kanë edhe angazhime shtesë politike ose legale në Kosovë ose punojnë në organizatat ndërkombëtare e në institucionet e huaja akademike, sipas gjitha gjasave edhe ata me orar të plotë atje. Sipas përgjigjeve të UPGJ ndaj pyetjeve shtesë të EE, 25 pjesëtarë të personelit janë me parakontrata, të gatshëm për të punuar me UPGJ "...pasi që universiteti të marrë një shenjë në lidhje me progresin e akreditimit..." (RVV f.261), që mund ta shpjerë UPGJ në një situatë pa zgjidhje, ata do të finalizojnë kontratat në mëmontin kur të kuptojnë se programet do t'iu akreditohe, dhe AAK do t'i akreditojë ata vetëm me kushtin që ata kanë numrin e kërkuar të personelit të rregullt. Kjo dilemë nuk i takon EE që ta zgjidhë, në fund vendimi final është vendim politik dhe duhet të merret nga bordi i AAK.

Fatkeqësisht, kjo situatë nuk është sqaruar aspak nga komentet e UPGJ ndaj raportit preliminar. Një munër ndryshimesh të sugjeruara janë cekur (veçanërisht sa i përket udhëheqjes së programit) dhe një numër i madh modulesh kanë ofruar emra të ri mësimdhënësish (shih komentet ndaj Raportit Preliminar, f 73 e në vijim). Megjithatë këta emra NUK janë në listën e personelit të ofruar nga AAK. Ka dy zgjidhje për këtë problem:

- a) UPGJ dhe AAK pajtohen në lidhje me një listë të pranueshme të personelit para mbledhjes së bordit dhe e konsiderojnë si të zgjidhur çështjen e problemit të personelit, kjo për nevojat e akreditimit.
- b) Nëse nuk ka një marrëveshje të tillë, EE duhet të konsiderojnë që personeli i cekur në aplikimin për akreditim NUK është personeli përgjegjës për lëndët dhe kur të jepet një vendim pozitiv në lidhje me akreditimin, atëherë ky personl do të duhej punojë pa njohjen e AAK. Sipas këndvështrimit të EE, kjo do të binte ndesh me rregulloret e AAK dhe do të shkelte praktikën e definuar më herët – që në anën tjetër do të ishin të mjaftueshme për të MOS rekomanduar akreditimin.

Përtej këtyre observimeve, i gjithë personeli me parakontrata kanë marrë trajnim të mjaftueshëm dhe në shumë raste edhe punë kërkimore dhe

publikime si dhe përvojë në vende të tjera. Për këtë arsye EE nuk ka dyshime sa i përket cilësisë së personelit dhe shprehimisht mbështet qasjen e Fakultetit (shih RVV f. 261) që të shikojnë dhe të marrin mbështetjen nga universitetet e huaja (Antwerpen, Piza) që të krijohet një mekanizëm për angazhim të profesorëve para se ata të fillojnë procedurën e zakonshme të punësimit.

3.6.03.1 Ngritja e personelit

Në mesin e çështjeve shtesë dhe informatave të kërkuara nga EE pas VI ishte edhe ajo e politikës së ngritjes së personelit. Në përgjigjen e tyre ndaj kësaj pyetjeje, Fakulteti shpreh se ata janë të vetëdijshëm në lidhje me nevojën për të përpiluar hapat e parë drejt zhvillimit të planifikuar të personelit. Tani për tani, EE nuk mund të presin më shumë, megjithatë një plan zyrtar i ngritjes së personelit që më parë është miratuar nga Këshilli i Fakultetit dhe sipas nevojës edhe nga Rektori dhe/ose Senati që të fitojë në qëndrueshmëri dhe në pranim, do të duhej të ofrohej në rastin më të vonë kur të riakreditohen programet e Fakultetit.

3.6.03.2 Politika e Mundësive të Barabarta

RVV hesht në lidhje me çështjen e politikës së mundësive të barabarta dhe me avancimin preferencial të anëtareve femra të personelit akademik, që si grup vuan nga një nën përfaqësim i shprehur në këtë drejtim, fakt i vërejtur gjatë VI. Plani i ngritjes së personelit pra do të duhej të përmbante një seksion të veçantë që do të trajtonte avancimin e femrave.

3.6.04 Bashkëpunimi në Hulumtime Ndërkombëtare

Në mesin e çështjeve shtesë dhe informatave të kërkuara nga EE pas VI ishte edhe politika e Fakultetit në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar në hulumtime. Në përgjigjen e tyre ndaj kësaj pyetjeje, Fakulteti shpreh se janë të vetëdijshëm për nevojën e përpilimit të një plani për zhvillim të bashkëpunimit ndërkombëtar. Tani për tani, ky bashkëpunim është në masë i kufizuar në partnerët nga Ballkani (me një përjashtim nga SHBA). Tani për tani EE nuk mund të presin më shumë dhe vullneti i mirë nga pjesëmarrësit dhe në veçanti nga financimi i nevojshëm qeveritar, ata në këtë kuptim e konsiderojnë përgjigjen e UGJ si një bërthamë të vogël por premtuese për zhvillim të mëtejshëm. Megjithatë, do të duhej që më së voni deri në rastin e një riakreditimi të mundshëm të programeve të Fakultetit në të ardhmen që të ketë një plan të zyrtarizuar të bashkëpunimit ndërkombëtar që do të ishte i miratuar nga këshilli i Fakultetit dhe sipas nevojës edhe nga Rektori dhe/ose nga Senati në mënyrë që të fitojë në qëndrueshmëri dhe në të qenit i pranueshëm.

3.6.05 Ndërlidhja në mes Teorisë dhe Praktikës – Internshipet

Si rregull i përgjithshëm, në të dyja programet që kanë kërkuar akreditim, marrëdhënia në mes teorisë dhe punës praktike është theksuar vetëm shkurtimisht në hyrje dhe në secilin nga përshkrimet e veçanta të programit. Në të dyja rastet, tabelat respektive NUK kanë paraparë module të internshipeve/studimeve praktike. Në kontrast me këtë, Në shkencat sociale në Evropën Perëndimore është standard që në programet BA të ketë punë praktike si pjesë e moduli obligativ në formë internshipi, më së shpeshti në pjesën e dytë të programeve tri vjeçare, që ceken në mënyrë adekuate në kalendarin e programit, që kanë edhe kreditë ECTS në mes 6-8 ECTS dhe që mbikqyrën në mënyrë adekuate nga personeli akademik, që i noton raportet e studentëve gjatë internshipit ose çfarëdo detyre tjetër më shkrim që i jepet atyre si pjesë e aktiviteteve të tyre jashtë fakultetit. Në këtë kuptim internshipet mund të zgjashin në mes 6 javësh deri në tre muaj, ato do të duhej të ishin në vij dhe sipas mundësive të obligueshme dhe të aranzhuara nga departamenti i mësimdhënies ose nga studentët me miratimin e të paktën mbikqyrësit të departamentit sa i përket internshipeve. Në komentin e tyre ndaj raportit preliminar, universiteti ka ndjekur rekomandimin e EE.

Duhet të futet një modul i veçantë obligativ në të trija programet e studimit që do të shërbente si një umbrellë e kredive ECTS që do të mund të shfrytëzoheshin për punë të ndryshme praktike të studentit.

3.6.06 Teza Bachelor

Siç u cek edhe në paragrafin 3.6.05 më sipër, EE u çuditën nga fakti që ANSJË nga programet nuk ofronte në mënyrë zyrtare një dritare kohore për të punuar në tezën e Bachelor. Modulet në Shkrim akademik, si rregull i përgjithshëm u ofruan në pjesën e parë të periudhës së studimeve, askund nuk kishte një modul në lidhje me shkrimin akademik të avancuar, në lidhje me metodat kërkimore të shkencave sociale aplikative, ose të ngjashme në semestrin e gjashtë. Përsëri, në praktikën e Evropës Perëndimore është standard që të caktohet një modul i veçantë që do të shoqëronte shkrimin e tezës në fund të studimeve trivjeçare. Fakti nëse kjo ka kredi të shumta ECTS (psh 15-20 ECTS) në mënyrë që të mundësojë shkrimin e tezës në të njëjtën kohë, ose nëse kjo ka kredi normale në përputhje me ngarkesës, dhe pastaj tezës i atribuohen kredi shtesë, kjo mbetet të vendoset nga ana e Departamentit. Në komentet e tyre ndaj raportit preliminar, UGJ ka ndjekur rekomandimin e EE.

a) të futet një modul obligativ që do të shfrytëzohej për përgatitjen e tezës në semestrin e gjashtë, b) të reduktohet numri i kredive për tezën në një shifër të përballeshme për shumën e përgjithshme të ECTS, psh. 10% e totalit.

3.6.07 Përafrimi i vlerave të ECTS me ngarkesat reale ekzistuese

EE ka vërejtur që përshkrimet e moduleve të veçanta në të trija programet nuk përmbajnë informata specifike në lidhje me ngarkesën e moduleve. Në vend të kësaj modulet obligative në përgjithësi kanë nga 6, ndonjëherë 4 ECTS kredi, kurse modulet zgjedhore, si rregull kishin nga 4 ECTS. Duke qenë se sistemi ECTS krijon një lidhje direkte në mes të shifrës dhe ngarkesës, atëhere ngarkesa të ndryshme të moduleve do të duhej poashtu që të reflektonin shifrat e ndryshme ECTS. Komenti në raportin preliminar ka ofruar një sistem të ri të pikëve ECTS për shumicën e moduleve duke filluar nga 4 dhe 6 pikë, megjithëse ata nuk thanë asgjë në lidhje me ngarkesat e moduleve të veçanta, kështu që EE ende nuk mund të vendosë nëse një sistem i caktuar i ECTS është ekuivalent me ngarkesën e vet, apo jo.

3.6.08 Metodatat e vlerësimit të suksesit të moduleve

EE poashtu vërejtë që programet respektive, metoda e vlerësimit të suksesit të modulit në të gjitha rastet ishte e njëjtë në aspektin skematik, psh

- Për Administratën Publike "...Metoda e vlerësimit: metoda kryesore e vlerësimit do të jetë provimi final, reprovimisht testi i parë dhe i dytë i organizuar gjatë semestrit. Si metodë shtesë do të jenë rezultatet e prezantimeve, por edhe aktivitetet e studentëve gjatë ligjëratave..."
- Për Shkencat Politike – NUK është cekur asnjë metodë e vlerësimit në të GJITHA përshkrimet e moduleve të Shkencave Politike, kjo paraqet një mangësi të madhe!!

Rekomandim: metodat e vlerësimit të moduleve duhet të ndryshojnë varësisht nga kërkesat e përmbajtjes së moduleve: në disa raste në formë të një punimi në fund të semestrit, në rastet tjera një provim me gojë, kurse në rastet tjera në numër testesh me shkrim, ose edhe një detyrë hulumuese dhe një prezantim verbal i rezultateve, gjithë këto mund të aplikohen.

Në komentet ndaj Raportit Preliminar, UGJ parimisht pranoi këto pika. Megjithatë ata NUK ofruan një përshkrim të riformuluar të moduleve, EE nuk mund kuptonin nëse UGJ ka ndjekur këtë këshillë në praktikë. Për këtë arsye, ne e mbajmë këtë pikë si referencë dhe do t'i rekomandonim AAK që të sigurojë që kjo çështje është shqyrtuar përsëri në raundin e ardhshëm të akreditimit.

3.6.09 Studimet e rregullta dhe ato me korrespondencë

Të gjitha programet bachelor që janë në shqyrtim ofrojnë studime të rregullta dhe me korrespondencë. Në RVV nuk cekën kushte ose rregullore për studime me korrespondencë në kuptim të: kohëzgjatjes së tyre, strukturës dhe përmbajtjes, modaliteteve të qasjes së studentëve, sistemit të tutorëve, Faqesave. Poashtu, RVV cek një numër vendesh për mundësinë e mësimin elektronik (e-mësimin) ose mësimin në distancë. Nëse UGJ do të fusë këtë sistem, që në vete do

të paraqiste një risi në sistemin terciar në Kosovë, do të ishte e nevojshme që të ofrohen disa informata më të detajuara dhe të sakta.

3.6.1 Bachelor në “Administratë Publike”

Prof. Dr. Reinhard Meyers

Universiteti është duke aplikuar për akreditim të një programi NË Administratë Publike që është standard prej tre vjetësh, me gjashtë semestra dhe 180 kredi ECTS në total, 60 ECTS/vit, që ofron 100 vende të lira për studime të rregullta dhe 40 vende për studime me korrespondenë kundrejt një Faqese të caktuar. Nga aspekti formal ky program përmbush kushtet e marrëveshjes së Bolonjës (në strukturën 3+2+3) dhe në parim është i krahasueshëm me skemat që ofrohen në hapësirën e Bolonjës. Përshkrimi i programit është informativ në masë të arsyeshme, përmban pikat më të zakonshme nga struktura e studimit përmes formave të mësimdhënies, caktimit të kredive ECTS dhe mënyrës së gradimit, deri të vlerësimi i studentëve dhe procedurat e notimit. Në aplikimin e parë, mungonin rregulloret në lidhje me punimin e tezës Bachelor, si dhe informatat në lidhje me raportit në mes të mësimit praktik dhe atij teorik (RVV f 311 e në vijim), krejt këto ishin të pakënaqshme (në të dyja pikat e cekura më sipër 3.6.05 & 3.6.06). Në komentet e tyre ndaj Raportit Preliminar, UGJ pranoi që të definohen kreditë ECTS për internship dhe për tezën Bachelor, edhepse përmes vetëm 6 ECTS teza duket disi e nënvlerësuar. Programi ofron lëndë në fushat në vijim (RVV f. 306 e në vijim).

1. Hyrje në Administratën Publike
2. Parimet e së Drejtës.
3. Hyrje në Mikroekonomi
4. Hyrje në Sociologji
5. Gjuhë e Huaj – Gjuhë Angleze 1
6. Hyrje në qeverisje dhe në politika
7. Hyrje në Kontabilitet Publik
8. Hyrje në Makroekonomi
9. Metodatat kërkimore në Shkencat Sociale
10. Gjuhë e Huaj I/2
11. Informatikë.
12. Shkrim Akademik
13. Hyrje në Politkat Publike
14. E Drejtë Administrative
15. E Drejtë Kushtetuese
16. Menaxhimi i Sektorit Publik
17. Qeverisja Lokale
18. Qeverisja dhe Politika e Kosovës
19. Gjuhë e Huaj – Gjuhë Gjermane 1

20. Menaxhimi i Burimeve Njerëzore në Sektorin Publik
21. Organizatat Ndërkombëtare
22. Sistemet Ligjore Krahasimore
23. Financat Publike
24. Institucionet dhe Politikat e BE
25. Ekonomia e Integrimeve në BE
26. Gjuhë e Huaj 2 – Gjuhë Gjermane 2
27. Administrata Publike në Vendet në Zhvillim
28. Menaxhimi Strategjik
29. Zhvillimi rajonal
30. Hyrje në të drejtën e BE
31. Procedura Administrative në Kosovë
32. Unioni Ekonomik dhe Monetar
33. Gjuhë e Huaj 3
34. Sistemi Politik i BE
35. Qeverisja Globale
36. Administrata Publike Krahasimore
37. Etika në Administratën Publike
38. E Drejta Biznesore Ndërkombëtare
39. Gjuhë e Huaj 3
40. Sociologjia e Globalizimit

Ajo që vërehej se mungon nga kjo listë në aplikimin fillestar ishin modulet në

- Proceset e vendim marrjes që mbulojnë caktimin e agjendës, formulimin e vendimeve, vendim marrjen, zbatimin e vendimeve, kontrollin e zbatimit (për efektet e parapara, kosto e auditimit, shqyrtimi ligjor i përmbajtjes dhe procedurave) dhe vlerësimin – si dhe ndikimin e lobimit në të gjitha fazat e procesit.
- Qeverisjen shumë niveleshe, që demonstrohet më së miri brenda kontesktit të fushave të veçanta të politikave në BE (konceptet, aplikimet, premtimet, rezultatet).
- Roli i burokracisë (zhvillimi i pikëpamjeve dhe mjeteve analitike nga Mak Veberi deri te Smith & Licari).
- Sektori i Tretë (OJQ-të ndërkombëtare, OJQ-të , QUANGO, GONGO, sindikatat, format më fluide të organizimit siç janë nismat qytetare, tavolinat e rrumbullakëta, etj) si dhe përfaqësuesit e interesit dhe grupet e avokimit të organizuara në mënyrë profesioanle si dhe raporti i tyre me vendim-marrësit politikë dhe zbatuesit burokratik.

- Administrata Publike dhe Mediet (që thellohet në raportet dialektike në mes të vendim-marrësve dhe administratorëve, agregatorët e interesit, mjetet, viktima e tjetrit).

Në komentet e tyre ndaj Raportit Preliminar, UGJ rriti programin duke futur lëndë të reja në lëndët e cekura më sipër në tabelën e përmbajtjes. Fatkeqësisht, ata poashtu ndryshuan (ndoshta padashje) numrin e lëndëve në menaxhimin e burimeve njerëzore në sektorin publik (që fillimisht ofrohej vetëm në semestrin IV, tani ofrohet në Semestrin III, IV dhe V). Në lidhje me këtë nuk u ofrua ndonjë shpjegim dhe nuk u dhanë përshkruesit e zakonshëm të moduleve (nga përmbajtja dhe synimi përmes metodave të mësimdhënies e deri të rezultatet e mësimin, metodat e testimit dhe literatura e rekomanduar) që të gjitha këto nuk u dhanë për modulet e shtuara në tabelën e programit.

Në parim EE pranon arsyetimin e tregut të punës për program, për të cilin ka nevojë në Kosovë, kjo në faqën e mesme dhe atë afatgjatë, pra ka nevojë për një numër të madh të administratorëve të kualifikuar në aspekt akademik në të gjitha fushat e jetës publike. Megjithatë, në pikëpamjen që UGJ është duke konkurruar me një numër institucionesh publike e private të arsimit të lartë që të gjitha ofrojnë programe në Administratën Publike, EE do të donte që UGJ të mbështeste argumentet e tyre përmes një hulumtimi të tregut empirik që do të detajonte zonën e marrjs së studentëve për Administratën Publike, nevojatpër personel në të ardhmen të shprehura nga punëdhënësit publik/jo publik, dhe shanset për punësim që kanë këta të diplomuar të UGJ dhe kjo të shprehej përmes shifrave të sakta dhe përmes demonstrimit të përqindjeve në të cilat mund të bazohesh. Në këtë kontekst, EE do të pranonte objektivat kryesore të programit, dmth përgatitja e studentëve përmes programit të Administratës Publike në një nivel njohurish të tilla që atyre do t'iu mundësonte:

- Përgatitjen e dokumenteve administrative, planifikimin dhe koordinimin e punës institucionale, arkivimin, regjistrimin e lëndëve administrative përmes shfrytëzimit të sistemeve informative.
- Zbatimin e njohurive profesionale për përmbushjen e detyrave të punës në institucionet shtetërore dhe në administratën publike, në organizatat private dhe në sektorin civil.
- Të zhvillojë mendimin kritik për punë në institucionet shtetërore dhe publike në rastet e shkeljes së rregullave administrative, burokraci dhe mungesë të transparencës.
- Të jenë të aftë në aspektin analitik që të zhvillojnë rolin e shtetit dhe administratës publike në dekadën e fundit në Republikën e Kosoës dhe në shtetet tjera në rajon.

- Të jenë në gjendje që të njohin trendet bashkëkohore dhe zhvillimet në institucionet shtetërore dhe publike dhe në menaxhimin publik qoftë në vendet në zhvillim apo në ato të zhvilluarat.
- Të marrë nismën që të identifikojnë dhe të adresojnë nevojat e mësimi për institucionet e shtetit dhe ato të administratës publike (RVV f. 310).

Sa i përket krijimit të hapësirës për internshipe dhe për teza të BA, argumentat e nevojshëm tashmë janë prezantuar më sipër, e njëjta vlen edhe për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me personelin akademik (me një përjashtim, një kontroll të emrave të mësuesve që japin mësim në një modul të veçantë, kundrejt listës së personelit që është dorëzuar në AAK. Rezultati i këtij kontrolli shpërfaq që i gjithë personeli që jep mësim në Administratën Publike i cekur në aplikimin fillestar është cekur në listën e AAK, përderisa ASNJË nga personat e cekur nga UGJ si persona përgjegjës për mësimdhënien e moduleve në përputhje me tabelat e ofuara me komentet e tyre në raportin preliminar (shih komentet f. 69 e në vijim) nuk është cekur në listën e AAK që kjo e fundit ia ka dhënë EE! Edhe vetë bartësi i lëndës për program nuk është cekur në mënyrë zyrtare nga AAK! Duke qenë se kjo është çështje e rëndësishme, EE sugjeron që AAK të sqarojë këtë çështje direkt me UGJ!!

Vërejtjet e përgjithshme në lidhje listën e literaturës së rekomanduar për modulet:

Gati një e treta e titujve të teksteve të cekura në modulet individuale është mëse 10 vjet e vjetër, disa tekste janë pranë ditëlindjes së tyre të 20të. Ka nevojë që të bëhet një ndryshim i thelle dhe rifresktues i listës së teksteve për lexim, që ne i cekim në vërejtjet e përgjithshme në Bibliotekën e Shkencave Sociale, në pjesën I më sipër.

Vërejtjet e veçanta në lidhje me modulet specifike:

- Hyrje në Kontabilitet Publik – a do të mbulonte kjo lëndë edhe Auditimin, apo kjo temë është trajtuar nga një modul tjetër?
- Qeverisja dhe Politika në Kosovë – teksti është identik me “Sistemin Politik të Kosovës” RVV f 281 dhe në vijim. A është ky një modul i njëjtë për Marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe për Administratën Publike në nivelin Bachelor?

(vini re, nuk ka ndonjë vërejtje në parim ndaj përdorimit të ekonomisë së shkallës, veçanërisht në disa nën fusha të lëndëve legale ose ekonomike, ose në disa lëndë hyrëse që janë të përbashkëta për gjithë programet BA që janë shqyrtuar këtu. UGJ do të mund të kontrollonte katalogët e lëndëve mësimore me një pikëpamje të tillë ekonomike; lëndët mësimore që do të ishin më të mëdha do të kishin nevojë për ndonjë hyrje në një formë të sistemit tutorial që udhëheqet nga studentët e diplomuar e nga i cili do të përfitonin studentët, kjo në mënyrë që të balancohet efekti i numrit shumë të madh të lëndëve në modulin kryesor)

- Zhvillimi rajonal, në vend të metodave standarde të vlerësimit, UGJ do të mund të shqyrtonte mundësinë e një krjimi të një simulimi ose një loje kompjuterike me role që do t'i jepte studentëve detyrën për të krijuar një plan zhvillimor për një fushë të caktuar të Kosovës (ose ndonjë rajoni imagjinar, nëse preferohet ashtu) që do të mund të testonte kompetencat e tyre hulumtuese, analitike të formulimit dhe të shitjes...

- Hyrje në të Drejtën e BE – në të mungon një pjesë e madhe e të Drejtës së butë të BE dhe e legjislacionit të shkrirë, vetërregullimit dhe bashkërregullimit – rregullat e rregullimit të bëra nga elementet e sistemit “Comitology”, metoda e hapur e koordinimit dhe elementet e fundit të caktimit të standardeve dhe vetë zbatimit që janë përfshirë në Traktatin e Lisbonës. Duke qenë se i gjithë materiali për lexim në këtë lënë daton nga 2006 ose me herët, duhet të ketë një rifreskim të literaturës (burimet më të fundit: Fabien Terpan: E Drejta e Butë në BE – Natyra në ndryshim e së Drejtës së BE. Revista e së Drejtës Evropiane, 21, 1, 2015 f 68-96).

- Procedurat Administrative në Kosovë – kjo lëndë ka një anim tradicional legal dhe nuk merr parasyh perspektivat moderne të qeverisjes shumë niveleshe. Çfarë në lidhje me sektorin e tretë, interesat e organizuara, lobingu, si dhe devijimet në sjelljen e qeverisjes së mirë siç janë monopolizimi i fuqive, korrupsioni, etj)?

- Unioni Ekonomik dhe Monetar – tekst i njëjtë si në pikën nr. 39 në programin Bachelor në Marrëdhëniet Ndërkombëtare (RVV f. 298 e në vijim), pra ky tekst përsëritet edhe në këtë modul? Literatura në lidhje me ekonominë e BE e botuar në 2003 nuk do të duhej shfrytëzuar më: Autorët do të mund të konsideronin bankën Lehman Brothers si një institucion i dobishëm në Wall Street...

- Sistemi Politik në BE – tekst i njëjtë me atë në pikën nr 40 në Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare (RVV f. 299 dhe në vijim), edhe në këtë modul teksti i njëjtë. Me përjashtim të tekstit të Grauwe 2012, e gjithë literatura është plotësisht e vjetëruar.

- E drejta Biznesore Ndërkombëtare – teksti i njëjtë me pikën nr. 45 në Bachelor në Marrëdhëniet Ndërkombëtare (RVV f 304). Sa i përket metodës së vlerësimit EE do të rekomandonte gjyqet e rrejshme, lojërat me role (psh si të përpilohet një kontrate shtijeje e tregtisë ndërkombëtare, një arbitrim i rrejshëm në mes palëve kontraktuese kundërshtare) ose ushtrime strategjike (psh si të përgatitet dhe të zbatohet një blerje ndërkombëtare ndaj konkurrencës nga pala e tretë) në vend të metodave tradicionale të cekura në RVV f. 304; Kjo do të mund të ishte e dobishme edhe sikur pjesë të këtij programi të ofroheshin nga praktikantët të së drejtës.

Përfundim:

Ka një mbivendosje të caktuar në mes të Administratës Publike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Studimeve të BE me modulet e njëjta që u cekën më sipër. Për arsye të efikasitetit akademik dhe ekonomisë së shkallës kjo qasje mund të mbrohet, nëse planifikohet në mënyrë të kujdesshme nga ana e UGJ (megjithatë, ata në atë rast do të duhej të tregonin mënyrën se si do të përballonin numrin relativisht të madh të studentëve në këto module, në të cilat në rastin më të keq shifra do të mund të arrinte deri 280 student/vit për modul). Megjithatë, nëse mbivendosja NUK është një vendim i vetëdijshëm, UGJ do të duhej të ripërpilonte përmbajtjen e modulit të cekur në mënyrë që të theksonte përmbajtjen e tyre të Administratës Publike dhe të ndante në mënyrë adekuate në mes tyre lëndët nga ato të Marrëdhënieve Ndërkombëtare.

Sa i përket ndryshimeve në program që janë përçuar përmes komenteve ndaj Raportit Preliminar, nuk mund të tejkalohet ndjesia që ato janë bërë disi kuturru: nuk janë dhënë përshkrime të përmbajtjes së moduleve të reja, gjendja sa i përket personelit mbetet plotësisht e paqartë për EE (nuk ka një listë të re të personelit të certifikuar nga AAK), udhëheqësi i lëndës në marrëdhënie parakontraktuale (çfarë pune mund të bëjë ai në program, që ta përgatisë atë për akreditim, kur kontrata e tij do të zbatohet vetëm **pas** vendimit pozitiv për akreditim).

Në parim, aplikimi paraqet një bazë të mjaftueshme për diskutime dhe për hyrje në përmirësime të mëtejme në program, siç është cekur më sipër. Megjithatë, siç duket ende shpërfaq shumë mangësi (të përmirësueshme) që duhet të zbatohen menjëherë. Universiteti mund të shpenzojë pak kohë dhe përpjekje që të shqyrtojë në mënyrë të thuktë programin dhe të sqarojë situatën sa i përket personelit me AAK në mënyrën që të gjithë do të mbeteshin të kënaqur. Si rrjedhojë ne do t'i rekomandonim AAK që:

Të mos akreditojë programin Bachelor në Administratë Publike në mënyrën siç është tani për vitin 2015/16, por të ftojë Universitetin e Gjakovës që të ridorëzojë një aplikacion të përmirësuar që do të merrte parasysh rekomandimet e bëra në këtë raport, kur të vijë koha të bëjë aplikimin për procedurën e akreditimit në vitin 2016.

Prof. em. Dr. Dr. h. c. mult. Reinhard Meyers

Professur "Internationale Beziehungen"

Universität Münster

3.6.2 Bachelor në “Shkencat Politike”

Prof. Dr. Reinhard Meyers

Universiteti është duke aplikuar për akreditim të një programi NË Administratë Publike që është standard prej tre vjetësh, me gjashtë semestra dhe 180 kredi ECTS në total, 60 ECTS/vit, që ofron 100 vende të lira për studime të rregullta dhe 40 vende për studime me korrespondenë kundrejt një Faqese të caktuar. Nga aspekti formal ky program përmbush kushtet e marrëveshjes së Bolonjës (në strukturën 3+2+3) dhe në parim është i krahasueshëm me skemat që ofrohen në hapësirën e Bolonjës. Megjithatë, përshkrimi i programit është shumë keqinformues, përmban pak nga pikat standarde prej strukturës së studimeve përmes formës së mësimdhënies, për caktimin e ECTS dhe për sistemin e gradimit, për vlerësimin e studentëve, procedurat e vlerësimit dhe rregulloret për përpilimin e tezës finale të Bachelor. Në vend që të bëjë këtë, teksti që ka të bëjë me objektivat kryesore dhe me rezultatet e mësimin (RVV f. 356-358) është përsëritur përsëri f. 359-360 në një formë të shkurtuar, por kësaj here në vend të paragrafeve me pika, teksti është paraqitur në formë të vazhdueshme. Lëndët që duhet të trajtohen janë si në vijim (të cituara nga RVV f. 354)

- Parimet e Sociologjisë
- Hyrje në Drejtësi
- Lëndë Zgjedhore
- Psikologji Sociale
- Hyrje në Ekonominë Politike
- Lëndë Zgjedhore, Bazat e Statistikës
- Metodatat hulumtuese në shkencat politike
- Shkenca Politike
- E Drejtë Kushtetuese
- Partitë Politike dhe Modelet Zgjedhore
- Marrëdhëniet Ndërkombëtare
- Menaxhim Politik
- Politika Publike Ndërkombëtare
- Sistem Politik Komparativ
- Politikatat e Marrëdhënive Ekonomike Ndërkombëtare
- Globalizimi si fenomen në shoqëritë moderne

Siç mund të vërehet nga kjo tabelë dhe nga një analizë më e thuktë e planprogramit të lëndëve, RVV f 361 dhe në vijim, ndarja e lëndëve është shumë konvencionale me ca dromca të globalizimit modern që i janë shtuar. Si rrjedhojë, përshtypja e përgjithshme e programit është që është tradicional dhe kundrejt saj

do të mund të theksohej që Shkenca Politike moderne tashmë ka ikur nga ndarja tradicionale, statike tripalëshe në Teori Politike, Qeverisje Krahasimore dhe Politika Ndërkombëtare dhe është shndërruar në një perspektivë ndaj politikave të orientuar prej proceseve, dhe politikave në kornizën e politikës, ose edhe ka tejkaluar kufinj të klasikë në mes tri fushave të cekura nga adoptimi i perspektivës të qeverisjes shumë niveleshe që jo gjithnjë ndjek caktimin e axhendës, artikulumin e interesave, vendim-marrjen, zbatimin e vendimeve në mënyrë të lirë nga poshtë në nivelin e sistemit global dhe anasjelltas, por ajo poashtu tejkalon kufinj të vetë Shkencave Politike, Sociologjisë Politike, studimeve të Sjelljes Politike dhe aspekteve funksionale e normative të ndërveprimit human, konfliktit dhe bashkëpunimit. Nga e gjithë kjo, struktura e përgjithshme e programit nuk jep shumë të dhëna. Përshtypja e përgjithshme e mëtejme e programit është që ai nuk ngrihet në nivelin e rolit mbizotërues që BE luan në Kosovë në veçanti dhe në Ballkanin Perëndimor në përgjithësi. Në program NUK ka asnjë lëndë në lidhje me Integrimet Evropiane. Sigurisht që mund të thuhet se ata që janë të interesuar në politikën e BE do të duhej të ndjekin programin Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe në Studime Evropiane që është analizuar më sipër, megjithatë një studiues i shkencave politike do të duhej të kishte të paktën njohuritë themelore në çështjet evropiane. Duke qenë se planprogrami i programit cek vetëm 16 lëndë mësimore në vend të numrit standard prej 30-36 (dhe përsëri ndodhë që të mos cek asnjë mundësi për modulën internship që do të ishte i vlerësuar me kredi ECTS) sigurisht që ka hapësirë për të rritur përmbajtjen evropiane të programit. Në vend të kësaj, hapësira e lirë është mbushur me një numër lëndësh zgjedhore për të cilat nuk janë dhënë as përshkrimet e lëndëve e as emrat e mësimit (nëse do ta pranoje faktin që Profesori TBD (anglisht për do të caktohet) do të jetë shumë produktiv, i gjithëndodhshëm, që ofron NËNTË lëndë zgjedhore në gjithë programin gjatë vitit). Për ta përmbyllur, përshkrimet e moduleve japin vetëm një skicë të shkurtër secila me nga 3 dhe rreth 15 rreshta në lidhje me përmbajtjen e vrazhdë të modulit, por ato nuk cekin asgjë në lidhje me synimet e programit, rezultatet e pritura të mësimit, modelit të mësimit, formave/metodave të mësimit, metodave të vlerësimit, lidhjes në mes teorisë dhe praktikës, ose literaturën standarde që duhet të përdoret nga vijuesit e lëndës. Në përgjithësi, ky paraqet një nga aplikimet më të dobëta që eksperti ka parë në Kosovë në gjashtë vite e më shumë. Më tej, në komentet e ofruara ndaj Raportit Preliminar (po aty, f. 65 e në vijim) UGJ nuk ka bërë (e as nuk ka sugjeruar) çfarëdo ndryshimi apo përmirësimi në aplikimin fillestar të dërguar për akreditim. Kështu që rekomandimi për AAK mund të jetë vetëm:

Të mos akreditojë Programin Bachelor në Shkenca Politike në formën e tanishme

Prof. em. Dr. Dr. h. c. mult. Reinhard Meyers
Professur "Internationale Beziehungen"
Universität Münster

3.7 Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Gjermane”

Prof. Dr. Volker Frederking

3.8.1 Vërejtje të përgjithshme

Ky kapitull i raportit final ka të bëjë me program të prezantuar në RVV 2 të UGJ dhe në bisedën mjaft konstruktive me tre përfaqësuesit e personelit akademik të gjuhës dhe letërsisë gjermane në UGJ: Prof. Dr. Brikena Kadzadej, Prof. Dr. Arber Celiku dhe Mr. Sc. Shpetim Zymberaj. Për këtë arsye Fakulteti i Filologjisë nuk ka dërguar komente shtesë në raportin preliminar duke qenë se programi i propozuar është identik me versionin final të prezantuar këtu.

3.8.2 Programi Akademik dhe Menaxhimi i Studentëve

Programi akademik i departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane i prezantuar në RVV 2 të 30.09.2014 është në përputhje me standardet ndërkombëtare. Kurrikula është paraparë si një program Bachelor tre vjeçar. Cilësia, shtrirja dhe synimet akademike të kurrikulës janë në përputhje me parimet e synuara nga procesi i Bolonjës. Profili i diplomave akademike dhe caktimi i kredive ECTS (3x60 ECTS, në total 180 ECTS) poashtu është në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ngarkesa duket të jetë e përbalueshme nga studentët.

Programi i studimeve në strukturën e vet të tanishme është në përputhje qoftë me standardet ndërkombëtare e poashtu me nevojat e shoqërisë në Kosovë në të tashmen dhe të ardhmen. Është e mundshme që kurrikula ofron dy lloje të lëndëve: obligative (O) dhe zgjedhore (Z). Në lëndët obligative ofrohen njohuri themelore të gjuhës dhe letërsisë gjermane, në lëndët zgjedhore studentëve iu është dhënë mundësia të zgjedhin në mes lëndëve me fokus në çështje të caktuara. Mbi këtë bazë janë cekur 40 lëndë mësimore. Përshkrimi i lëndëve (faqe 24-72) është cekur dhe në përgjithësi është i qartë. Marrëdhënia në mes pjesëve teorike dhe praktike të lëndëve mësimore në përgjithësi është e mjaftueshme. Shumica e literaturës së propozuar është e botuar së voni dhe përfaqëson një nivel të mirë të njohurive dhe të kapaciteteve mësimdhënëse.

Përshkrimi i ofruar në SER 2 në faqe 13 dhe në faqe 20-23 megjithatë është i ndryshëm dhe pjesërisht ka gabime, veç kësaj mungojnë disa lëndë. Në mënyrë të detajuar lista është:

1. Gramatika e Gjuhës Shqipe (O)
2. Gjuhë Praktike (*sic !*) Gjuhë B (1)

- Faqe 20:(O) Linguistika praktike (sic !) e gjuhës B(1)*
3. Gjuha C (1) (O)
Faqe 20:(O) Gjuha C1
 4. Tipologjia tekstuale e gjuhës B (O)
Faqe 20:(O)Tipologjia tekstuale e Gjuhës B
 5. Hyrje në Linguistikë (O)
 6. Gramatika e Gjuhës Shqipe II (O)
 7. Gjuhë Gjermane II (O)
 8. Metodologjia e Punës Kërkimore (O)
Faqe 20:(O) Metodologjia e punës kërkimore
 9. Fonetika B (O)
Faqe 20:(O) Sintaksa e Gjuhës B
 10. Gjuhë e Huaj(O)
 11. Civilizim Gjerman (O ose Z ???)
 12. Reflektimi i historisë Gjermane në Literaturë
Faqe 20:(O) Nuk ekziston!
 13. Teoria e Literaturës (O)
 14. Gjuhë Gjermane III (morfologjia) (O)
 15. Letërsi Gjermane (O)
 16. Linguistikë e Përgjithshme (O)
 17. Gjuhë dhe Letërsi(Z)
Faqe 20:(Z) Letërsia e Gjuhës
Faqe 21:(Z) Nuk ka specifikim
Faqe 21:(Z) Nuk ka specifikim
Faqe 21:(Z) Nuk ka specifikim
 18. Sintaksa e Gjuhës Gjermane (O)
Faqe 21 : Sintaksa Gjermane
 19. Gjuhë Gjermane IV (O)
 20. Letërsi Gjermane (O)
 21. Histori Moderne/ Gjuha Gjermane Bashkëkohore (Z)
 22. Tipologjia Tekstuale e Gjuhës Gjermane (Z)
 23. Albanologji (Z)
 24. Psikologji/Edukim (Z)
 25. Hyrje në Pragmatikë (O ose Z ???)
 26. Leksikologji Gjermane (O)
 27. Hyrje në Semiologji (O)
Faqe 22: Semiologji Gjermane
 28. Letërsi Gjermane(O)
 29. Hyrje në teorinë e komunikimit (O)
Faqe 22: Hyrje në Teorinë e Komunikimit
 30. Civilizimi gjuhësor (Z)
Faqe 22: Civilizimi i një gjuhe
 31. Gjuhë e Huaj(Z)

32. Elementet e Civilizimit Gjuhësor (Z)
33. Lëndë e Avancuar e Gjuhës Gjermane (Z)
34. Linguistika e Tekstit (O)
35. Letërsi Gjermane (O)
36. Gjuhë Gjermane VI (O)
37. Metodatat e mësimdhënies me praktikë profesionale (O)
38. Teza BA (Z)
39. Hyrje në teorinë e përkthimit dhe të interpretimit (Z)
40. Sociolinguistika (Z)

Faqe 23: Socio Linguistika

Përveç këtyre kundërthënieve në mes të dy listave të lëndëve mësimore, duhet të theksohen edhe disa probleme tjera.

1. RVV 2 theksoi që programi Bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Gjermane është konceptuar si një program i përgjithshëm i kualifikimit, i plotësuar me lëndë që ofrojnë trajnim në fushën e metodologjisë dhe didaktikës së Gjuhës Gjermane si gjuhë e huaj” (f. 14). Është i kënaqshëm fakti që në kurrikulë janë cekur kompetencat bazike në gjuhën dhe letërsinë gjermane në një anë dhe kompetencat në metodologjinë dhe didaktikën e gjuhës gjermane si gjuhë e huaj në anën tjetër, këto janë cekur si synime që duhet arritur. Në fakt, të dyja synimet janë marrë në konsideratë nga programi i studimeve. Megjithatë, raporti nuk është i mjaftueshëm. Një mangësi e madhe e kurrikulës është fakti që përmban vetëm një lëndë mësimore për didaktikën dhe metodologjinë e gjuhës dhe letërsisë gjermane: nr 37 në semestrin e fundit. Kjo lëndë mësimore nuk mjafton për të kualifikuar studentët për profesionin e mësimdhënies në një formë bindëse dhe të mjaftueshme. Nevojiten të paktën tri lëndë obligative:

- a) Metodologjia dhe didaktika e gjuhës gjermane si gjuhë e huaj
- b) Metodologjia dhe didaktika e letërsisë gjermane
- c) Metodologjia dhe didaktika e gjuhës dhe letërsisë gjermane në përgatitje për praktikë profesionale në shkolla.

2. Një aspekt tjetër i kurrikulës që ka hapësirë për përmirësim është fakti që mungojnë konsideratat në lidhje me literaturën e përshtatshme për mosha të caktuara. Veçanërisht literatura për fëmijë dhe të rinj do të duhej të ishte pjesë e kurrikulës, sepse fëmijët e vegjël kanë nevojë për literaturë që është në përputhje me moshën e tyre. Studentët e fokusuar në Edukimin e gjuhës dhe letërsisë gjermane duhet të kenë njohuri në lidhje me atë lloj literature të veçantë.

3. Duhet shtuar edhe librat e filmat si pjesë obligative e kurrikulës, sepse ato ofrojnë forma tjera të mësimit të gjuhës dhe letërsisë gjermane dhe kodeve tjera estetike. Këto shense të veçanta do të duhej shfrytëzuar për mësimdhënie dhe mësim në mënyrë moderne në shkolla dhe (në përgatitje) në universitet. Studentët duhet të mësojnë se çfarë llojesh adaptimesh mediale ka (librat audio, filmat). Kjo është një diçka pa të cilën nuk bën në mënyrë që t’iu mundësohet

puna profesionale si mësimdhënës, pra që të shfrytëzojnë librat me zë (audio librat) dhe filmat në mënyrë produktive.

4. Në kurrikulë ka një zbrazëti të madhe sa i përket integritit të medieve digjitale. Kompjuterët dhe interneti ofrojnë mundësi të mëdha për përmirësimin e procesit të mësimin dhe të mësimdhënies së gjuhës dhe letërsisë gjermane për studentët dhe për nxënësit e tyre në të ardhmen. Gjatë studimeve të tyre, studentët duhet të familjarizohen me potencialet e medieve digjitale që janë specifike për tema të caktuara. Është si parakusht shfrytëzimi i medieve digjitale si mësues i gjuhës dhe letërsisë gjermane në shkolla.

Rekomandime

1. Kurrikula do të duhej që të paktën të përfshijë tri lëndë obligative që kanë të bëjnë me çështjet e didaktikës dhe metodologjisë së temave:

- a) Metodologjia dhe didaktika e gjuhës gjermane si gjuhë e huaj
- b) Metodologjia dhe didaktika e letërsisë gjermane
- c) Metodologjia dhe didaktika e gjuhës dhe letërsisë gjermane si përgatitje për ushtrimet praktike në shkollë

2. Literatura për fëmijë dhe të rinjë do të duhej të ishte pjesë obligative e kurrikulës.

3. Audio librat dhe filmat duhet të shtohen në pjesën obligative të kurrikulës.

4. Mediet digjitale siç janë kompjuteri, interneti, etj duhet të shtohen në pjesën obligative të kurrikulës.

3.8.3 Personeli

Për programin bachelor në gjuhën dhe letërsinë gjermane, në RVV 2 janë cekur 7 pjesëtarë të stafit akademik me fokus kryesor gjuhën dhe letërsinë gjermane:

1. Edllira Bushati, Dr. Prof. ass.

Morfologjia, sintaksa, Historia e gjuhës gjermane, semantika

2. Naser Mrasori, Dr. Prof. ass.

Literatura gjermane e shekullit 20, analiza e teksteve të letërsisë

3. Brikena Kadzade, Dr. Prof. Dr.

Gjuha Gjermane, Tekstet Linguistike, Shkrim Akademik, Civilizim

4. Sabina Osmani, Dr.

Letërsi Gjermane: Mesjetë, Rilindje, romanticizëm klasik

5. Eriola Mlloja, Mag. Asistente

Gjuha Gjermane, Fonetika

6. Vjosa Hamiti, Mag., Asistente

Gramatika e Gjuhës Gjermane

7. Flutura Mehmeti, Mag. Asistente

Mësimi praktik i gjuhës gjermane për studentët e programeve tjera

Por asnjë nga këta kolegë nuk është pjesë e stafit akademik të rregullt të UGJ, nga ajo çfarë mund të shoh. Me fjalë të tjera: departamenti nuk ka një profesor të rregullt të gjuhës dhe letërsisë gjermane. Veç kësaj: dy nga tre kolegët me të cilat fola si anëtarë të stafit përgjegjës në lidhje me kurrikulën, kjo gjatë VI, këta ishin Prof. Dr. Arber Celiku dhe Mr. Sc. Shpetim Zymberaj nuk janë cekur fare në dokumentin zyrtar të RVV 2. Këto kundërthënie janë befasuese dhe do të duhej larguar.

Rekomandim

Është e nevojshme që Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane të pranojë personel të rregullt, të paktën një profesor të rregullt me orar të plotë dhe një ose dy pjesëtarë të personelit akademik si të rregullt. Sipas mendimit tim ky është një kusht pa të cilin nuk bën për akreditim.

3.8.4 Studentët

RVV ka cekur 50 studentë, që pritet të jenë në vitin e parë akademik 2015/2016. Kjo qasje duket të jetë realiste. Megjithatë, nuk janë formuluar pritshmëritë dhe llogaritjet e mëtejme.

Rekomandim

Është e nevojshme që departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane të llogarisë se sa studentë janë të nevojshëm për programin Bachelor dhe sa studentë mund të priten në vitet në vijim.

3.8.5 Puna Kërkimore

Mundësitë e punës kërkimore në departamentin e gjuhës dhe letërsisë gjermane janë të kufizuara. Kjo është e kuptueshme në fazën fillestare. Megjithatë, përfaqësuesit e departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane duhet të përpilojnë një strategji hulumtuese në të ardhmen e afërt.

Rekomandim

Fokusi i punës kërkimore do të duhej të ishte ngrija e hulumtimeve empirike të koncepteve didaktike në fushën e “Gjuhës Gjermane si Gjuhë e Huaj”. Kjo në mënyrë që të përforcohen mundësitë reale të punës hulumtuese, që letërsia e re shkencore të shtohet në bibliotekën e UGJ.

3.8.6 Bashkëpunimi Ndërkombëtar

Bashkëpunimi ndërkombëtar i departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane është i bazuar ende në kontaktet personale të personelit. Bashkëpunimi ekziston me universitetet në Maqedoni dhe Shqipëri.

Rekomandim

Kontaktet ndërkombëtare duhet të intensifikohen dhe të zgjerohen në vende të tjera dhe në universitete tjera. Është e nevojshme që departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane të marrë pjesë në projektet e BE. Në mënyrë që të bëhet program i suksesshëm në ndërkombëtarizim, ai duhet të përmirësojë dukshmërinë e vet ndërkombëtare dhe të punojë në uebfaqe në gjuhën angleze dhe atë gjermane.

Unë rekomandoj që të ndërlidhet çështja e akreditimit me atë të personelit. Kjo sa i përket listës zyrtare të personelit dhe kundërthënive të cekura dhe problemeve, që sipas mendimit tim janë pika mjaft të dobëta të programit të ri. Me këto kushte, unë rekomandoj që të mos akreditohet programi i ri në nivelin Bachelor në *Gjuhë dhe Letërsi Gjermane* në UGJ për vitin 2015/2016, por që t'i sugjerohet UGJ që të dorëzojë përsëri një version të ndryshuar që do të merrte parasysh rekomandimet e këtij raporti, kjo në afatin e procedurës së akreditimit të vitit 2016.

Prof. Dr. Volker Frederking

Didaktik der deutschen Sprache und Literatur

Universiteti i Erlangen-Nürnberg, 21 qershor 2015.